

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7832 E martë 26 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**

Letra e dashurisë së Emanuel Makronit ndaj Europës, ishte një teatër i pastër, dhe tipike e presidentit francez. Ndoshta më shumë se çdo politikan tjetër, Makron ...
Vijon në faqen 20

Nga ALEXANDER CLARKSON

Shoumeni i madh i Europës



Opinion *i* **Ditës**

Dërisa lexoj për betejën e vazhdueshme të Mbretërisë së Bashkuar me Brexit-in, asociacioni im i parë gjithmonë është i ndërlidhur me Stalinin. Në fundvitet...
Vijon në faqen 21

Nga SLAVOJ ZIZEK

Të mos zgjedhësh të keqen më të vogël



“Në KQZ raportuan 25 mijë dollarë”

Prokuroria: PD nuk deklaroi 650 mijë USD për lobim. Basha: S’kemi shkelur ligjin

Kryetari i PD 90 minuta në prokurori: Të bëjnë publike letërporositë nga SHBA dhe Skoci

Nga VALENTINA MADANI

Kreu demokrat Lulzim Basha dhe dje sqarime për 90 minuta në prokurori në lidhje me hetimet për financimet e fushatës së PD-së në Amerikë. Për Bashën, prokuroria po heton për deklarimet që PD-ja ka bërë në formularët e deklarimit ...
Në faqen 3

MINISTRIA E FINANCAVE: TRASHËGIMTARËT QË PËRFIJOJNË DEMSHPERBLIMIN

TE PERNDJEKURIT, 1 MIJE EMRAT QË MARRIN PARATË

Të dhënat e detajuara për çdo trashëgimtar, çfarë dokumentesh duhet të dorëzojë secili prej tyre. Përfutuesit e kështit të tretë, nevojitet llogari bankare aktive



(Në foto) Ish-të përndjekur gjatë një proteste

Në faqen 12-14

VRASJA NË THETH
Ekzekutimi i “Nardit të bujtinave”, në kërkim autori, 3 të tjerë në pranga
Në faqen 7

RREFIMI
34-vjeçarja: Burri më ka thyer dhëmbët, më qëlloi me tullë në kokë
Në faqen 11

“KONSULLI I NDERIT”
Tellohet skandali, SHISH firmosi pastërtinë e indianit në kërkim
Në faqen 8

UNIVERSITETI
Rama prezanton portalin, studentët: Po mendojmë të rinisim protestat
Në faqen 10

INTERVISTA/ Ish-deputetja e PD: Rama po e mbulon krizën me rrecka të grisura

Grida Duma: Opozita të jetë bindëse, ndërkombëtarët s’mund të injorohen

“S’duam poste në qeveri, por dialog. Premtimet e pamenduara mund të jenë vargonj”

Nga VALENTINA MADANI

Ish-deputetja Grida Duma paralajmëron se në rast mosreflektimi nga ana e kryeministrit Edi Rama radikalizimi i mëtejshëm është i paevitueshëm. Zj.Duma thotë për “Gazeta Shqiptare” se për opozitën nuk është

sfidë të bindë qytetarët se Edi Rama duhet të ikë; sfida e opozitës është ta realizojë politikisht largimin e tij. Por Grida Duma beson se opozita mund të sakrifikojë mandatet, por në asnjë mënyrë s’do të sakrifikojë rolin dhe genien e saj. Zj.Duma i kujton lidershitip të PD-së se



opozita duhet të jetë bindëse në përpjekjen e saj për të treguar se di të ndërtojë qeverisje, jo thjesht të rrezojë qeveri. Ndërsa Edi Ramës i bën të qartë se është mendjehetësi të përpigësh të injorosh një opozitë që lufton, duke ndërmarrë sipas saj ...
Në faqen 4-5

**LOBIMI
AKUZAT**

Akuza pretendon se PD në shkelje të ligjit nuk ka bërë deklarin për këto pagesa

Prokuroria: PD nuk ka deklaruar financimin prej 650 mijë \$ për lobim

"Njëra nga pagesat është bërë nga "Biniatta Trade"

Prokuroria e Tiranës ka reaguar dje për herë parë në lidhje me dy letërporositë e përcjella nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Skocia mbi shpenzimet e Partisë Demokratike gjatë fushatës së zgjedhjeve të vitit 2017 për të cilat konstatohen mospërpunje mes deklarimeve të kryera dhe shpenzimeve reale. Nëpërmjet një deklarate të shpërndarë në media, organi i akuzës ka sqaruar se Partia Demokratike në raportin e saj të financimit të zgjedhjeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve ka deklaruar vetëm 25 mijë dollarë si pagesë për lobim, ndërsa gjithmonë sipas prokurorisë nga të dhënat dhe provat rezultojnë se ajo ka bërë edhe në pagesë tjetër në shumë e 650 mijë dollarëve për çështjen e njohur ndryshe si "Mother Jones", të cilën nuk e ka deklaruar. "Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, Tiranë janë marrë në pyetje ditën e sotme me datë 25.03.2019, shtetasit Lulzim Basha, Gazmet Bardhi, Ilir Dervishi, dhe Arben Ristani.



Prokuroria e Tiranës

LETËRPOROSIA

"Sipas akteve të ardhura nga letërporositë, e mbërritura nga SHBA-ja dhe Skocia rezultojnë në mënyrë të qartë pagesat e bëra dhe të padeklaruara, çfarë nënkupton se subjekti PD nuk ka bërë asnjë deklarin për këto pagesa në kundërshtim me ligjin", - sqaron më tej prokuroria.

SPIROPALI

"Lulzim Basha gënjen si derri i knaqun i Migjenit sapo del nga dera e prokurorisë. Pastaj kur prokuroria ia nxjerr në shesh gënjeshtat, bën Sokratin e përvuejtun si i persekutuar politik. Është koha të përgjigjesh Lulzim. As derri as Sokrati s'të ndihmojnë dot!"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, gjatë fushatës zgjedhore

Lobimi i PD në SHBA, Zguri: Të majtët nuk pranuan hetimin

Çështja e lobimit të PD-së në zgjedhjet e vitit 2017 është bërë objekt debatesh edhe në mbledhjen e djeshme të Komisionit të Ligjeve ku ishte ftuar të raportonte mbi punën një vjeçare të KQZ-së, kryetari i këtij institucioni Klement Zguri. Teksa kryetari i PD-së pyetej në prokurorinë e Tiranës mbi fondet e shpenzuara gjatë fushatës për lobim në Shtetet e Bashkuara, socialisti Alket Hyseni kërkoi shpjegime në Komisionin e Ligjeve, nga kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Klement Zguri, mbi hetimet e këtij institucioni mbi transparencën e financave të partisë më të madhe opozitare. Hyseni përmendi dyshimet, sipas të cilave PD ka përfutur financime të dyshimta ruse. Këtij inter-



esi Zguri iu përgjigj duke theksuar se është kërkuar nga administrata e KQZ-së një hetim i thelluar, i cili është refuzuar të miratohet nga anëtarët e KQZ të propozuar nga të majtët. "Ka qenë një propozim i administratës i mbështetur prej meje për të pasur hetim të thelluar për këtë gjë dhe është

refuzuar nga anëtarët tuaj. Administrata e KQZ me mbështetjen time ka kërkuar në mbledhjen zyrtare hetim të thelluar për rastin konkret. Është refuzuar", tha Zguri. Më tej ai në fjalën e tij ai tha se kriza politike që ka përfshirë vendin po prek cilësinë dhe standardet e zgjedhjeve. "Përplasja politike me shumë gjasë nuk do e lërë KQZ pa e përfshirë në vorbullën e vet në organizimin e zgjedhjeve lokale. Për këtë Kuvendi duhet ta mbrojë KQZ-në. Zgjedhjet meritojnë një administratë të fortë dhe profesionale. Që zgjedhjet lokale të jenë me standarde Kuvendi duhet të mbështesë komisionin, sepse mund të kemi nevojë për ndihmën tuaj" iu shpreh ndër të tjera Zguri.

pagesa në shumën prej 650 000 dollarësh për efekt lobimi në SHBA, të cilat nuk janë deklaruar ligjërisht nga subjekti PD. Njëra nga këto pagesa rezultojnë të jetë bërë nga një shoqëri e huaj dhe konkretisht "Biniatta Trade", shpeshet prokuror-

ia në këtë deklaratë. "Biniatta Trade LP" rezultojnë të regjistruar në Edinburg të Skocisë dhe është në pronësi të një zinxhiri kompanish të regjistruara në Belize, një shtet i Amerikës Qendrore i njohur si "parajsë fiskale". Ajo është një partneritet i

krijuar nga dy kompani: "Asverro Corp" dhe "Liminez Commerce". Ndërkohë që sa i përket thirrjes dhe marrjes në pyetje të kryetarit të PD-së, Lulzim Basha dhe drejtuesve të tjerë demokrat, prokuroria thekson se kjo bëhet në funksion të

Ballat: Basha matrioshkë ruse, gënjeu në derën e prokurorisë

Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Socialiste, Taulant Balla duke marrë shkas nga deklaratat e prokurorisë, akuzoi kreun e PD-së, Lulzim Basha se gënjeu me deklaratën pasi doli nga prokuroria. Në një status në rrjetet sociale, Balla thotë se nuk duhet të lejohet që Basha të tërheqë për hunde njerëzit. "Ju që i shkoni pas një njeriu si ky, i vetmi që gënjen edhe tek pragu i derës së prokurorisë, si mund t'ia lejojnë vetes t'ju tërheqë për hunde një matrioshkë si Lulzim Basha! Me lehtësinë e gënjeshtarit profesionist ai thotë që hetimi për financimet e PD ka nisur me kërkesë të PD një vit e gjysëm më parë!!! Po ai kallzimi im ndaj tij për këtë çështje pse u bë? Po FBI-së dhe Departamentit Amerikan të Drejtësisë, ky ia ka kërkuar hetimin për veten? Po autoritetetve skoceze mos ua ka kërkuar Lulzimi të kryejnë hetimet për gati 1 milionë dollarë të padeklaruara, që i dolën në Amerikë si para ruse?", - shkroi Balla. Më tej ai u bëri thirrje mbështetësve të opozitës që të i besojnë Bashës. "O ju njerëz që ju sjellë verdallë Lulzimi, thirrini mendjes e mos u bëni kukulla të kësaj matrioshke gënjeshtare!", - shkroi Balla.



zbardhjes së të vërtetës dhe se deklaratat e tyre i shërbejnë hetimit të kësaj çështjeje. Marrja në pyetje e shtetasve të mësipërm është një proces normal në rrjedhjen e zhvillimit të hetimeve dhe në kohën e çmuar si të përshtatshme në raport me provat

e administruara. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Tiranë garanton hetim objektiv dhe të paanshëm në lidhje me këtë çështje, duke u bazuar në prova dhe në ligji, si dhe të pandikuar nga deklaratat mediatiqe", - mbyll deklaratën e vet prokuroria.



Kreu i PD-së pyetet 90 minuta në prokurori për kontratat e lobimit në Amerikë

Lobimi, Basha: Të publikohen letërporositë e SHBA dhe Anglisë

"Letërporositë treguan se PD s'ka shkelur ligjin"

Valentina Madani

Kreu demokrat Lulzim Basha dha dje sqarime për 90 minuta në prokurori në lidhje me hetimet për financimet e fushatës së PD-së në Amerikë. Për Bashën, prokuroria po heton për deklarimet që PD-ja ka bërë në formularët e deklarimit në KQZ, për shpenzimet. Z.Basha kërkoi nga prokuroria që të bëjë publike përgjigjet e letërporosive të ardhura nga SHBA dhe Anglia, të cilat sipas tij, tregojnë qartë që PD dhe drejtuesit e saj nuk kanë shkelur ligjet. Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, tha për mediat të hënën jashtë prokurorisë ku ishte thirrur për të dhënë informacion për persona që mund të kenë lidhje me hetimin për dosjen e lobimit në SHBA, se PD dhe zyrtarët e saj nuk kanë shkelur ligjin as në Shqipëri, as në Britani dhe as në SHBA. "Dua të bëj të qartë se hetimi i hapur prej një viti e gjysmë, bëhet mbi bazën e nenit 190 mbi çështjen e plotësimit të formularëve të deklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Pra, çështja që po hetohet, me kërkesë të PD, është nëse këto formularët janë mbushur apo jo siç duhet. Ky është hetimi dhe jo gënjeshtër dhe shpifjet për të cilat është investuar fuqimisht qeveria, e cila e aktivizon këtë hetim, sa herë i duhet për nevojat politike", deklaroi Z.Basha. Pasi ka qëndruar për më se një orë në zyrën e prokurorit Gjergji Tako, Basha në dalje deklaroi se ishte thirrur si person që ka dijeni për rrethanat e hetimit. Sipas tij çështja ka nisur me kërkesë të PD për formularët e paraqitur në KQZ. Prej prokurorisë kërkoi që të zbardhë përgjigjet e letërporosive të ardhura nga Amerika dhe Skocia. Kryedemokrati i kërkoi prokurorisë të zbardhë përgjigjet e letërporosive të mbërritura nga Britania e Madhe dhe SHBA, siç tha ai para 6 muajsh. "Ka një vit e gjysmë që ka nisur ky hetim, ka më shumë se 6 muaj që kanë ardhur përgjigjet nga SHBA dhe nga Britania e Madhe, nga Skocia, të cilat vërtetojnë se as PD dhe asnjë drejtues i PD



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

DEKLARATA
"Ka një vit e gjysmë që ka nisur ky hetim, ka më shumë se gjashtë muaj që kanë ardhur përgjigjet nga SHBA dhe Britania e Madhe, nga Skocia, të cilat vërtetojnë se as Partia Demokratike, as një drejtues i PD nuk ka shkelur asnjë ligj, as në Shqipëri, as në SHBA dhe as në Britaninë e Madhe", deklaroi Z.Basha.

Lobimi i PD, Çupi: Konkluzionet e prokurorisë të paprecedenta

Ish-deputetja e PD-së, Dhurata Çupi foli dje për dy letërporositë e ardhura nga SHBA dhe Skocia, ndërsa tha se PD-ja nuk ka fshehur asgjë dhe të gjitha shpenzimet janë deklaruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Sipas Çupit, prokuroria e Tiranës ka bërë veprime të paprecedenta duke shtuar se ka nxjerrë përfundime pa kryer më parë asnjë hetim mbi rastin e pretenduar për lobimin e selisë blu në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe lidhjet e mundshme me Rusinë. "Basha ka deklaruar para mediave, ashtu siç ka deklaruar edhe në prokurori. Është hera e parë që prokuroria ka nxjerrë përfundime pa bërë hetime. Letërporositë e ardhura si nga SHBA ashtu edhe nga Skocia, janë porosi që janë deklaruar edhe në faqen zyrtare. Konkluzionet e prokurorisë janë të paprecedenta përgjatë 30 viteve demokraci. Prokuroria po përdoret politikisht", theksoi ish-deputetja e PD-së në News 24.



HETIMI

"Hetimi i hapur prej 1.5 viti bëhet mbi bazën e nenit 190 për çështjen e plotësimit të formularëve të deklarimit në KQZ. Pra, çështja që po hetohet me kërkesë të PD është nëse këto formularë janë mbushur apo jo siç duhet. Ky është hetimi dhe jo gënjeshtër për të cilat është investuar qeveria, e cila e aktivizon këtë hetim sa herë i duhet për nevojat politike. Ka një vit e gjysmë që ka nisur hetimi", -tha Z.Basha.

650 mijë USD për lobim, PD: Prokuroria po përdoret politikisht

PD e cilësoi deklaratën e prokurorisë së Tiranës për çështjen e lobimit të kësaj partie në SHBA të paligjshme, e gënjeshtërt, e paprecedentë, vetëdiskredituese dhe e gatuar politikisht. Pas deklaratës së prokurorisë se PD nuk ka deklaruar 650 mijë dollarë për lobimin në SHBA, reagoi selia blu, e cila akuzoi se organi i akuzës po përdoret politikisht. Sipas PD-së, prokuroria ka dalë në konkluzione pas përfunduar hetimit. Për demokratët nuk është shkelur asnjë ligj dhe të gjitha shpenzimet për vitin 2017 janë të deklaruar. "Deklarata e prokurori



ishtë është e paligjshme, e gënjeshtërt, e paprecedentë, vetëdiskredituese dhe e gatuar politikisht. Dalja me konkluzione hetimore ende pa përfunduar hetimin, si asnjëherë më parë në këto 30 vjet, tregon se Prokuroria

po përdoret politikisht dhe po i shërben propagandës qeveritare kundër opozitës së vendit. Partia Demokratike nuk ka shkelur asnjë ligj dhe ka deklaruar të gjitha shpenzimet e kryera në vitin 2017. Pasi gënjeshtër e madhe që kishte ngritur për hetimin e Partisë Demokratike i plasi në dorë, pas informacioneve të ardhura nga SHBA dhe Skocia, Edi Rama në dëshpërim ka vendosur të përdorë sërish prokurorinë duke e kthyer nga institucion të ligjit në institucion qesharak propagandë", thuhet në reagimin e PD-së.

Lobimet, mediat e huaja jehonë lajmit të Bashës në prokurori

Hetimet e Prokurorisë për lobimin në Amerikë dhe marrja në pyetje e kreut të PD-së, Lulzim Basha dje është përcjellë edhe në mediet më prestigjioze ndërkombëtare: "The New York Times", "VOANews", "Seattle Times", "Wral", "Fredericksburg", "KPVI" dhe "The Washington Times". Në një deklaratë prokuroria e Tiranës tha: Udhëheqësi i demokratëve, Lulzim Basha dhe tre politikanë të tjerë u pyetën përse partia e tyre nuk kishte deklaruar paratë e shpenzuara në Shtetet e Bashkuara. Basha mohoi thyerjen e ligjeve, duke thënë se përgjigjet nga autoritetet në Shtetet e Bashkuara dhe në Britani "dëshmojnë se Partia Demokratike dhe udhëheqësit e saj nuk kanë shkelur ndonjë ligj", shkruan "The New York Times". Risjellim në vëmendje se dyshimet janë se PD ka shpenzuar rreth 650,000 dollarë të padeklaruar në formularin e KQZ-së, gjatë zgjedhjeve parlamentare të dy viteve më parë. Por këto akuzat janë hedhur poshtë nga demokratët. Ishte "Mother Jones", ajo që në një shkrim të publikuar kohë më parë ka pohuar se demokratët kanë marrë fonde sekrete nga burimet ruse duke përdorur një lobist amerikan, Nick Muzin, i cili ishte paguar nga një kompani e lidhur me Rusinë e quajtur "Biniatta Trade".

nuk ka shkelur asnjë ligj as në Shqipëri, as në SHBA dhe as në Britaninë e Madhe. Ndaj i kemi kërkuar prokurorisë dhe ju nisim edhe ju që t'i kërkoni t'i bëjë publike përgjigjet e ardhura nga SHBA dhe Britania e Madhe, -u shpreh kreut i PD-së. Z.Basha bëri të ditur se me letërporositë ishte njohur vetëm dje, gjatë qëndrimit të tij në prokurori prej pothuajse 90 minutash. Për mediat

iu shpreh se gjithçka është politike dhe se në letërporositë të ardhura prej Skocisë dhe Amerikës nuk rezultoi asnjë shkelje. I thirrur për hetimin për lobimet ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm i Partisë Demokratike Gazmend Bardhi, i cili deklaroi se kishte të njëjtin qëndrim si dhe kryetari Basha. Në prokurori për hetimet u paraqitën edhe financiar i PD-së Ilir Dervishi si dhe ish-

sekretari i përgjithshëm Arben Ristani. Për Bashën thirrja e zyrtarëve demokratë është bërë në bazë të një axhende politike të Edi Ramës. Prokuroria nisi hetimet pas shkrimit në revistën amerikane "Mother Jones" lidhur me fondet që kjo parti ka paguar për aktivitetet lobimi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, para zgjedhjeve të qershorit 2017.

AKSIONI I OPOZITËS

INTERVISTA

Ish-deputetja: Qeveria përgjegjëse për situatën, nëse s'ka reflektim, radikalizimi i paevitueshëm

Duma: Opozita duhet të bindë, mision jo vetëm rrëzimi i qeverisë

"Premtimet e pamenduara mund të jenë vargonj në këmbë"

Valentina Madani

Ish-deputetja Grida Duma paralajmëron se në rast mosreflektimi nga ana e kryeministrit Edi Rama radikalizimi i mëtejshëm është i paevitueshëm. Zj.Duma thotë për "Gazeta Shqiptare" se për opozitën nuk është sfidë të bindë qytetarët se Edi Rama duhet të ikë; sfida e opozitës është ta realizojë politikisht largimin e tij. Por Grida Duma beson se opozita mund të sakrifikojë mandatet, por në asnjë mënyrë s'do të sakrifikojë rolin dhe qenien e saj. Zj.Duma i kujton lidhshmëritë të PD-së se opozita duhet të jetë bindëse në përpjekjen e saj për të treguar se di të ndërtojë qeverisje, jo thjesht të rrëzojë qeveri. Ndërsa Edi Ramës i bën të qartë se është mendjehetësi të përpqesh të injorosh një opozitë që lufton, duke ndërmarrë sipas saj hapin qesharak të zëvendësimit të saj me dordolecë politikë. Për kundërshtitë e ndërkombëtarëve ndaj aksionit të opozitës, Grida Duma shprehët se nuk mund të injorohen shqetësimet e tyre, por ajo përmend se opozita po sakrifikon nga vetja pikërisht për të ruajtur thelbin e institucioneve kyçe të demokracisë.

Zj.Duma, Shqipëria aktualisht është në protestë për cilat arsye? Edhe sa kohë opozita do t'i nxjerrë njerëzit në shesh?

Opozita ka kryer veprimin politik fundor; ka dërguar mandatet. Ishte një akt politik i kryer me besim të plotë në atë që ne të gjithë besojmë - rruga e vetme për t'u përballur me sistemin politik aktual, është dalja prej këtij sistemi. Për pasojë opozita është e vetëdijshme se ky hap nuk ka kthim pas. Opozita do të përfaqësohet nga protesta dhe sot opozita është vetë protesta. Sa kohë opozita është në sheshet e Shqipërisë protestat do vijojnë pa asnjë limit.

Shqiptarët janë të pakënaqur me qeverisjen socialiste, por Edi Rama vazhdon të jetë kryeministër. Si po i bindin qytetarët që ta rrëzojnë atë nga pushteti?



Ish-deputetja Grida Duma

ALTERNATIVA

"Paralelisht me atë që ndërmerr për të zhbërë pushtetin e Ramës, Partia Demokratike duhet të fillojë të artikulojë më fort alternativën e saj ndërtuese",-tha ish-deputetja e PD-së.

Rënia e Edi Ramës nuk lidhet vetëm me bindjen e shumicës së qytetarëve se ai duhet të ikë. As vetëm me besimin e opozitës se ai duhet larguar. Mendoj se këto dy rryma janë takuar prej kohësh. Shumica e heshtur e qytetarëve nuk e do Ramën. Opozita sot e merr forcën dhe aksionin e saj politik radikal pikërisht, sepse qytetarët janë të bindur që Edi Rama duhet të ikë edhe formalisht. Sepse qeverisja ka rënë. Edi Rama është kryeministër i rënë jo si individ; kryeministri është qeverisja, qeverisja është mirëqenia ose jo për qytetarët. Në 6 vite të qeverisë, Rama ka sakrifikuar pa mëshirë jetën dhe mirëqenien e qindra-mijëra shqiptarëve. Ikja në masë nga Shqipëria nuk është thjeshtë pasoja e një ngërçi të momentit. Është shenja e dëshpërimit të shqiptarëve, një dëshpërim që nuk mbulohet

dot me një, dhjetë, apo njëzet samite diaspore. Ikja në masë edhe e atyre që kanë një profesion të mirë, të ardhura të kënaqshme, por që gjithsesi zgjedhin të jetojnë tjetërkund, është barometri më i qartë i plakjes dhe shkretimit të së nesërme. Për shqiptarët është e qartë që me Ramën e sotmja është po aq e keqe sa ç'është e nesërmja e pashpresë. Ikja e Edi Ramës është një mënyrë për t'i thënë ndal ikjes së qytetarëve. Për opozitën nuk është sfidë të bindë qytetarët se Edi Rama duhet të ikë; sfida e opozitës është ta realizojë politikisht largimin e tij. Dhe opozita do ta bëjë këtë.

Vendimi politik i PD-së për protestën, a do të çojë drejt një aksioni edhe më radikal për largimin e kryeministrit Edi Rama?

Aksioni është radikal që në këto momente. Sigurisht, në mungesë të reflektimit,

MANDATET

"Opozita mund të sakrifikojë mandatet, por në asnjë mënyrë ajo s'do të sakrifikojë rolin dhe qenien e saj. Është mendjehetësi të injorosh një opozitë që lufton, duke ndërmarrë hapin qesharak të zëvendësimit të saj me dordolecë politikë",- tha Grida Duma.

radikalizimi i mëtejshëm është i paevitueshëm, jo thjeshtë si vendim politik, por edhe si hap i radhës. Opozita mund të sakrifikojë mandatet, por në asnjë mënyrë ajo s'do të sakrifikojë rolin dhe qenien e saj. Është mendjehetësi të injorosh një opozitë që lufton, duke ndërmarrë hapin qesharak të zëvendësimit të saj me dordolecë politikë. Nuk ekziston asnjë mënyrë në të cilën opozita të mund të pajtohet me arrogancën e pushtetit të Ramës, dhe me mendjehetësinë që kjo arrogancë sjell.

Cili është plani i PD-së për tej kësaj situatë, çfarë ndodh nëse Edi Rama nuk dorëhiqet?

Mbetet të jemi së bashku me ju dëshmitarë faktikë të betejës së Partisë Demokratike. Është e paduhur që të shpalosen paraprakisht detajet e aksioneve të ardhshme politike. Ndërkaq, paralelisht me atë që ndërmerr për të zhbërë pushtetin e Ramës, Partia Demokratike duhet të fillojë të artikulojë më fort alternativën e saj ndërtuese. Besoj jemi të gjithë të qartë që shumica dërrmuese e shqiptarëve nuk e do rrëzimin e Ramës vetëm që Partia Demokratike të vijë në pushtet. Ikja e Ramës është një parakusht që shqiptarët të përmirësojnë jetën e tyre. Ikja e Ramës nuk është përfundimi, është fillimi i shumëllojshmërisë së një rrugë për zhvillim. Opozita duhet të jetë bindëse në përpjekjen e saj për të treguar se di të ndërtojë qeverisje, jo thjesht të rrëzojë qeveri. Nëse sot nëpër protes-



QEVERISJA

"Opozita duhet të jetë bindëse në përpjekjen e saj për të treguar se di të ndërtojë qeverisje, jo thjesht të rrëzojë qeveri. Nëse sot nëpër protesta i kemi shqiptarët me vete, ne duhet të dimë që atyre krahas forcës së kundërshtimit, t'u japim edhe aftësinë për të ngritur diçka më të mirë se kjo që duam të lëmë pas",-tha zj.Duma.

ta i kemi shqiptarët me vete, ne duhet të dimë që atyre krahas forcës së kundërshtimit, t'u japim edhe aftësinë për të ngritur diçka më të mirë se kjo që duam të lëmë pas.

Pse kaq kundërshtarë të huajt ndaj vendimit të opozitës për dorëzimin e mandateve? Cila është zgjidhja?

Ndërkombëtarët theksojnë nevojën që zgjidhja të vijë me rrugë institucionale. Ata theksojnë nevojën e ruajtjes së stabilitetit. Partia Demokratike po përpqesh të bëjë më shumë se mirë detyrën e saj për të fuqizuar institucionet e demokracisë reale, ashtu siç e kërkojnë shqiptarët dhe mbështetësit e saj; thënë kjo, mbetet të vi-

pikërisht për të ruajtur thelbin e institucioneve kyçe të demokracisë - Kushtetutën, zgjedhjet e lira, pavarësinë e gjyqësorit, balancën e pushteteve, përfaqësimin demokratik.

Si e konsideroni rolin e Presidentit Ilir Meta për zgjidhjen e krizës? A është e gatshme PD-ja të hyjë në bisedime për të gjetur një zgjidhje që do të çonte drejt normalitetit të situatës së krijuar në vend?

Partia Demokratike e ka shtruar rrugën për bisedime, duke shtjelluar opozionin e saj; qeveri tranzitore. Ne nuk duam dialog thjesht për të kaluar radhën. Ne nuk duam as ca poste në qeveri që të plotësojmë numrat apo të ndajmë politikisht pushte-

NDËRKOMBËTARËT

"Në asnjë mënyrë nuk mund të injorohen shqetësimet e justifikuar të ndërkombëtarëve. Jemi të qartë që të gjithë që aksionet opozitare nuk kanë nevojë për justifikim, opozita po sakrifikon nga vetja pikërisht për të ruajtur thelbin e institucioneve kyçe të demokracisë",- theksoi zj.Grida Duma.

jojmë akoma më tej për të intensifikuar dialogun me ndërkombëtarët. Në asnjë mënyrë nuk mundet të injorohen shqetësimet e justifikuar të ndërkombëtarëve. Por, nga ana tjetër, besoj se jemi të qartë që të gjithë që aksionet opozitare nuk kanë nevojë për justifikim, opozita po sakrifikon nga vetja

vet. Nevoja për dialog dikton parakushtin që dialogu të jetë i plotë. Qeveria tranzitore është një parakusht që dialogu të jetë real, dhe realiteti i këtij dialogu të ketë kuptim. Presidenti i Republikës që në fillimë ka ushtruar mandatit duke i shkuar në limitet fundore kompetencave kushtetuese, besoj me



"Rama po mbulon krizën me rreca të grisura, opozita po zëvendësohet me dordolecë politikë"

PD, Duma: Nuk duam ca poste në qeveri, por dialog real

"Ndërkombëtarët s'mund të injorohen, të qartësohen mirë?"

het për të qeverisur mirë, qëllimi final nuk mund të jetë dita e fitores së zgjedhjeve, por dita kur sigurohemi se kemi hedhur hapa drejt mirëqeverisjes. Premtimet e pamenduara para fitores shpeshherë mund të jenë vargonj në këmbë pas marrjes së saj.

A është gati Partia Demokratike që të qeverisë ndryshe shqiptarët...?

Ka çdo potencial që të jetë gati. Në zgjedhjet e fundit Partia Demokratike u ristrukturoi duke prodhuar një sekretariat jo tejet politik dhe me ndarje funksionale por ashtu duke ndryshuar disi formulën e menaxhimit të saj. Parimi i ri i ndjekur mesa duket ka qenë ndarja e funksioneve politike ndaj atyre administrative. Vijimësia e ndërtimit të qeverisë hije duhet parë nën dritën e këtyre përfaqësuesve të reja. Që do të thotë që nga qeveria e nesërme dhe çdo funksion tjetër politik nuk do të varet nga funksionet, por mundet nga kontributet dhe meritat e vlerësuar mirë. Themeli i qeverisjes së nesërme do të jetë meritokracia dhe vetëm mbi këtë themel mund të ndërtohet zhvillimi.

Me kë do të qeverisin demokratët nesër në push-



tet dhe cilat do të jenë hapat e parë që do ndërmarrë PD-ja kur të vijë në pushtet?

Partia Demokratike duhet të jetë luajale me çdo mbështetës dhe kontributor të saj. Në takimet me demokratët theksohet domosdoshmëria që së pari të jenë demokratët ata të cilëve do tu njihet kontributi real i fitores. Është e domosdoshme që edhe në qeverisje të kemi një formulë të mirëpërcaktuar që harmonizon kontributin e demokratëve me atë të aleatëve të PD. Qartësia para-prake në ndarjen e përgjegjë-

sive siguron nisjen e një qeverisjeje të përgjegjshme-pasi fitorja, sado e vështirë dhe e merituar, vlen vetëm nëse qeveriset mirë. Në nuk do të përpigemi të fitojmë siguri për veten duke u përpjekur të bëjmë propagandë me kalimin "nga fitorja në fitorje", siç bën kjo qeveri. Hapat e parë tanë do të jenë konkretë - ekspozimi i keqeverisjes nuk do të lidhet më me akuzat, sado të mirëargumentuara, të një opozite, por me masat dhe veprimet e një ekzekutivi që në thelb të punës së tij do të ketë

PREMTIMET

"Kur luftohet për të qeverisur mirë, qëllimi final nuk mund të jetë dita e fitores së zgjedhjeve, por dita kur sigurohemi se kemi hedhur hapa drejt mirëqeverisjes. Premtimet e pamenduara para fitores shpeshherë mund të jenë vargonj në këmbë pas marrjes së saj", - tha ish-deputetja e PD-së.

çmontimin e sistemit që po i merr frymën këtij vendi. Nuk ka pse të ketë, dhe as do të ketë dyzime lidhur me këtë.

DIALOGU

"PD e ka shtruar rrugën për bisedime, duke shtjelluar opsionin e saj; qeveri tranzitore. Ne nuk duam dialog thjesht për të kaluar radhën. Ne nuk duam as ca poste në qeveri që të plotësojmë numrat apo të ndajmë politikisht pushtetet. Nevoja për dialog dikton parakushtin që dialogu të jetë i plotë", -deklaroi zj. Duma.

qëllimin për të ristabilizuar figurën e presidentit, jo thjesht si regjistër noterial. Besoj që e njëjta qasje në këto momente i shërben vendit ndërsa jemi në momentet më të nevojshme për balance pushtetesh në kushtet e mungesës së Gjykatës Kushtetuese dhe kapje politike e organeve të drejtësisë e prokurorisë.

Opozita ka paralajmëruar se do të bojkotojë zgjedhjet lokale të 30 qershorit gjë që veçse do të thellojë krizën në vend.

Ajo që e thellon krizën në vend është konsiderimi i saj si normalitet. Kryeministri Rama po bën gjithçka që ta trajtojë krizën e vendit si diçka normale, të cilën ai mund ta zgjidhë me veprime spektakolare -si për shembull me zëvendësimin brenda natës së gjysmës së kabinetit qeveritar. Por të mbulosh krizën me rreca të grisura, veçse e thellon krizën. Nuk është opozita shkaktarja e krizës; as nuk është opozita përgjegjësa për thellimin e saj. Pasi dogji mandatet, opozita nuk mund të përdoret më si një shiringë mpirëse nga Rama, që do të topitë ndjeshmërinë e popullit ndaj qeverisjes së keqe.

PD-ja ka deklaruar se përveç zgjedhjeve lokale do të jenë edhe ato parlamentare? Sa e mundur është që ato të jenë njëherësh dhe brenda 2019? Kur mendohet të zhvillohen zgjedhjet e parakohshme?

Çdo gjë është e mundur; ajo që ne duam të pamundësojmë është vajtja në zgjedhje pa garanci të mbrojtjes së votës së lirë.

Duhet ndryshuar në themel situata aktuale në mënyrë që vota të mbrohet; në funksion të këtij qëllimi, cilado formulë që jep rezultat duhet të jetë e dëshirueshme.

Nëse do të ketë zgjedhje të parakohshme, a do të mund t'i fitojë opozita?

Opozita duhet të bindë shqiptarët se ajo di të qeverisë më mirë, jo thjesht se mund të fitojë zgjedhjet. Kur lufto-

Protestat para parlamenti dhe protesta kombëtare e 13 prillit, por edhe përgatitja për zgjedhje të parakohshme, mblodhi sërisht dje demokratët me qëllim intensifikimin e përpjekjeve për aksionin opozitar kundër qeverisë. Kreu i PD-së Lulzim Basha thirri dje një mbledhje me ish-deputetët dhe kryesinë e kësaj force politike. Mbledhja u zhvilluar me dyer të mbyllura ndërsa, burimet thanë se z.Basha, ka qenë kritik me ish-deputetët dhe anëtarët e kryesisë, duke ju kërkuar atyre që të intensifikojnë takimet me qytetarët. Nga mbledhja me dyer të mbyllura mësohet se Basha ka kërkuar angazhim maksimal nga ish-deputetët në qarqet e tyre jo vetëm për protestën e së enjtes përpara parlamentit, por edhe atë kombëtare që do të mbahet në 13 prill në orën 18.00 të pasdites në bulevardin "Dëshmorët e Kombit". Z.Basha kërkoi që ish-deputetët që të jenë më aktivë e të mos rrinë në kafene

Kreu i PD: Gati për zgjedhje të parakohshme Basha kritika ish-deputetëve: Mos rrihi kafeneve, takoni njerëzit në terren



ditën e protestave, por të dalin në ballë të saj. "Nuk duhet të rrihi në kafe me njerëzit tjetrit, por të jeni në ballë të protestës", -mësohet t'u ketë thënë Basha ish-deputetëve. Lulzim Basha, iu kërkoi, gjithashtu, ish-deputetëve dhe kryesisë, që të qëndrojnë në gatishmëri dhe të jenë të gati për zgjedhjet vendore,

por dhe zgjedhje parlamentare kurdo që ato të zhvillohen. Ndërkohë në mbledhje janë përcaktuar dhe grupet e punës që do të merren me organizimin e protestës së 13 prillit, ndërsa më pas Basha thirri në takime të veçanta disa ish-deputetë duke ju dhënë detyra konkrete për organizimin. Porosia e radhës

ZGJEDHJET
Krahas organizimit të protestave z.Basha u kërkoi ish-deputetëve dhe anëtarëve të kryesisë që të gjitha strukturat të jenë gati për zgjedhje të parakohshme dhe të njohin qytetarët me programin ekonomik të Partisë Demokratike.

ishite intensifikimi i takimeve me qytetarët dhe pjesëmarrje masive në tubimet e opozitës. Krahas organizimit të protestave Basha ka kërkuar që të gjitha strukturat të jenë gati për zgjedhje të parakohshme dhe të njohin qytetarët me programin ekonomik të Partisë Demokratike.



Rudina Hajdari flet për përjashtimin nga PD: Nuk më nxjerrin dot nga ajo parti

Deputetja Rudina Hajdari deklaroi mbrëmë se nuk do të mund ta përjashtojë nga PD sa kohë e votojnë demokratët. Hajdari e ftuar në "A-SHOW" në News 24, u pyet për deklaratat e disa muajve më parë për të lënë mandatin e deputetes si dhe përjashtimin nga PD. "Momentin që unë e mora këtë vendim, prita pak kohë. Doja të deklarata e disa muajve më parë për të lënë mandatin e deputetes tim për studentët. Por gjëj rastin ta shpjegoj sot; ka të njëjtin vij logjike me atë që ndodh sot. Studentët domin ndryshim. U ngritën kundër kësaj klase politike. Kjo mua më mërzi shumë. Në ato momente isha në Qytetin Studentit, para bustit të tim at the në anën tjetër ishin studentët", -tha zj.Hajdari. Sa i perket përjashtimit nga PD ajo u përgjigj: "Nuk më nxjerrin dot nga ajo parti. Është nëse demokratët më thonë nuk të votojmë më. Kjo shihet tek vota".

Siguria miraton ndryshimet, vetingun e policëve do e bëjë SHÇBA

Vetingun për policët do ta kryejë Shërbimi për Çështjet e Brendshme. Komisioni i Sigurisë miratoi dje ndryshimet në ligjin e vetingut në polici që i japin SHÇBA-së kompetencën për të kryer kontrollin e figurës dhe pasurisë së policave të niveleve të ulëta dhe të mesme. Ndërkohë që sipas këtyre ndryshimeve vetingun e drejtuesve të lartë të policisë do e kryejë një komision i posaçëm që njihet zyrtarisht si Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit. Ndërkohë që ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj kërkoi në Komisionin e Sigurisë shtyrjen e afatit të vetingut në polici. Sipas ligjit aktual, vetingun në Policinë e Shtetit duhet të përfundojë në mars të vitit 2020. Por duke parë ecurinë si po ecën vetingun për gjyqtarët dhe prokurorët, kohën që



Ministri i Brendshëm, Sandër Lleshaj

po merr, ministri kërkoi heqjen e limitit kohor, i cili ishte marsi i vitit 2020 për mbylljen e procesit në Policinë e Shtetit. "Ne i japim kohë vetes për të vazhduar procesin e vetingut edhe më gjatë, në mënyrë që ai të realizohet gjërisht" - tha ministri. Sa i përket ndryshimit thelbësor atij për përcaktimin e institucioneve që

do bëjnë vetingun Lleshaj kërkoi që në vend të dy komisioneve të përkohshme, që do të ngriheshin me ligjin aktual, të vazhdojë SHÇBA të kryejë detyrën, për të vetuar pjesën e mbetur të Policisë së Shtetit, Gardës dhe vetë SHÇBA-së. "Në fazën e parë nga Komisioni i Jashtëm i vetingut do të votohet trupa drejtuese e Policisë së Shtetit, pra rreth 300 drejtues të Policisë së Shtetit, që në thelb përbën që nga niveli komisarjat e deri në Drejtorinë e Përgjithshme dhe vetë SHÇBA-ja dhe pastaj pjesën tjetër do të kryhet nga vetë SHÇBA, e cila, siç e thashë, e ka për mision ligjor të bëjë pikërisht këtë detyrë sot dhe për sa kohë të ekzistojë", - tha ai.



Pjerin Ndreu: Të përjashtohet Garda e Republikës nga vetingun

Deputeti socialist Pjerin Ndreu ka kërkuar dje në Komisionin e Sigurisë që Garda e Republikës të përjashtohet nga vetingun. "Unë mendoj se Garda duhet të përjashtohet nga kjo skemë e vetingut. Garda ka një rol të shërbimeve statike kryesisht të personaliteteve të larta të shtetit dhe të homologëve që vijnë. Ndërsa policia ka tjetër pozicion dhe unë mendoj se duhet të ndahen" - tha Ndreu. Ndërsa Myslim Murrizi, demokrati që u përjashtua nga PD-ja, pasi nuk pranoi që të dorëzonte mandatin u shpreh se vetingun në polici mund ta bënte SHÇBA-ja nëse do të ishte lënë që të punonte pa presion dhe të mos përdorej si kamxhik. "Duhet të jemi më të hapur. Vetingu erdhi si pasojë e delirrit të atij që ju vendosët ministër pas kampionit. Ne kemi SHÇBA-në, por nuk është lënë dhe është përdorur si kamxhik" - tha ai.

Deputetja socialiste flet për lajmin e sherrit me kryeministrin në kongres

Dorëheqja nga kryetare e PS-së së Tiranës? Gjylameti: Jam në detyrë

"Lista pasqyron një shumëllojshmëri"

Deputetja socialiste Blerina Gjylameti vazhdon të jetë ende në detyrën e kryetares së Partisë Socialiste për Tiranën. Ajo ka thyer heshjen dhe duke folur në rubrikën "Opinion" në "News 24" ka mohuar zërat dhe lajmet se kishte dhënë dorëheqjen nga drejtimi i socialistëve të kryeqytetit. Gjithsesi, pyetjes nëse kish të pasur debate me kryeministrin në kongres lidhur me listat e këshilltarëve bashkiakë dhe mënyrën e organizimit të takimit "Bashkia që duam", Gjylameti i është përgjigjur shkurt duke theksuar se ishte ende në detyrë. "Unë jam në detyrë. Të gjitha të tjerat janë spekulime të ditës. Do të flisja për ato çfarë arritëm në atë kongres dhe jo për këto. Kemi një projekt të madh për të çuar përpara. Unë vazhdoj të punoj për projektin "Shqipëria që duam" më shumë se sa të dëgjoj çfarë thotë një individ apo një tjetër", - tha ajo duke iu shmangur diskutimit për këtë çështje. Por pavarësisht kësaj burime nga PS bën me dije se ka pasur një përplasje të fortë mes saj dhe kryeministrit Edi Rama, jo vetëm gjatë kongresit, por edhe disa ditë para tij. Por pavarësisht këtyre debateve duket se është bërë e mundur evitimi i largimit të saj nga detyra e kryetarit të PS-së së Tiranës. Gjithsesi, përgjigjet që ajo dha gjatë intervistës së djeshme tregojnë se mes saj dhe eksponentëve të caktuar në PS nuk janë marrëdhëniet më të mira të mundshme. Kështu pyetjes se si janë marrëdhëniet e saj me kryetarin e Bashkisë së Tiranës,



Kryeministri Rama dhe deputetja Blerina Gjylameti gjatë kongresit të PS-së

Gjylameti iu përgjigj se e rëndësishme është puna në ekip se sa marrëdhëniet individuale mes dy personave. "Unë besoj se qoftë në pjesën e qeverisjes vendore dhe me këtë rast me bashkitë që duam, ajo çfarë kemi treguar gjatë kësaj kohe është që ekipet funksionojnë si të tilla me frymë grupi me fokusin e veçantë dhe jo tek marrëdhëniet individuale që ka personi tek personi, por mbi të gjitha tek fryma që ka ekipi dhe e gjitha kjo në shpërbllim të atyre që na kanë besuar", - u shpreh ajo. Ndërkohë që pyetjes për listat e këshilltarëve bashkiakë të Tiranës, për të cilat u

fol se ishin dhe shkaku i debatit me kryeministrin, Gjylameti deklaroi se ajo sjell përmirësim dhe se përfaqëson një kombinim në të gjitha aspektet. "Lista pasqyron një shumëllojshmëri. Unë mendoj që është në listë e kombinuar në të gjithë aspektet, mendoj se do jetë një listë që do shënojë një përmirësim të PS. Nuk flasim për mbështetës të një individi apo një tjetri, por të ekipit. PS ka treguar vit pas viti kombinim mes brezash. Idetë e të rinjve i bashkëngjiten atyre që kanë shumë eksperiencë në PS", - tha ajo. Ndërsa duke folur për krizën politike dhe ofertën që Rama i bëri opozitës

Marrëdhëniet

"Unë besoj se qoftë në pjesën e qeverisjes vendore, qoftë në pjesën e qeverisjes vendore, dhe me këtë rast me bashkitë që duam, ajo çfarë kemi treguar gjatë kësaj kohe është që ekipet funksionojnë si të tilla me frymë grupi me fokusin e veçantë dhe jo tek marrëdhëniet individuale që ka personi tek personi, por mbi të gjitha tek fryma që ka ekipi dhe e gjitha kjo në shpërbllim të atyre që na kanë besuar", - u shpreh ajo.

për të dalë prej saj, Gjylameti u shpreh se opozita duhet të tregojë nëpërmjet zgjedhjeve vendore se është shumicë. "Unë besoj që në Shqipëri ajo që duhet të bëjmë është mos krijojmë precedentë të rrezikshëm. Në 2017 qytetarët besuan në alternativën e PS, kontratat jonë me qytetarët përfundon në 2021 dhe nëse një pakicë do i mbivendosej shumicës do e bënte vetëm duke respektuar standardet e demokracisë. Kemi heshur për kundërt asaj që është përbaltja e opozitës. Ajo ofertë e kryeministrit është për të treguar përmes parimeve të demokracisë nëse janë shumicë", - u shpreh ajo.



Meta: Shqiptarët dhe grekët meritojnë të jetojnë në harmoni

Presidenti Ilir Meta mori pjesë dje në ceremoninë e organizuar në Ditën Kombëtare të Greqisë. Përmes një postimi në rrjetet sociale ai ndau edhe përshkrimet e tij, shoqëruar me një mesazh për dy kombet. Kreu i Shtetit shkruan se shqiptarët dhe grekët meritojnë të jetojnë gjithmonë në harmoni dhe begati. "I lumtur të merrja pjesë sot në ceremoninë e organizuar me rastin e Ditës Kombëtare të Greqisë. Në këtë ditë feste e gëzimi të fqinjëve tanë uroj që edhe bashkëpunimi i partneriteti ynë të udhëhiqen nga trashëgimia më pozitive dhe e ardhmja e përbashkët e dy popujve tanë në një rajon më të begatë të Europës së Bashkuar", - shkroi Meta. Më tej ai theksoi se emigrantët shqiptarë që punojnë dhe jetojnë në Greqi si dhe minoriteti grek në vendin tonë janë dhe duhet të shërbejnë për të forcur edhe më shumë miqësinë mes dy vendeve. "Minoriteti grek dhe komuniteti shqiptar në Greqi, ura shumë të forta lidhëse në marrëdhëniet e shkëlqyera tradicionale, por edhe mjaft premtuese mes dy popujve tanë. Shqiptarët dhe grekët meritojnë të jetojnë gjithmonë në bashkëpunim, harmoni e begati. Zoti e bekoftë miqësinë shqiptaro-greke!" - shkruan Meta në mesazhin e vet.

Reagon vëllai i viktimës: Nuk kemi konflikte, kanë ngatërruar person

SHKODËR

Ekzekutimi i "Nardit të Bujtinave", arrestohen 3 bashkëpunëtorët, shpallet në kërkim atentatori

Operacioni i koduar "Step by step", në pranga 2 vëllezërit Gilbert e Kleandro Toma dhe 20-vjeçari Alfred Martini

Gjashtë ditë pas ekzekutimit me 18 plumba të biznesmenit nga Thethi, Ferdinand Polia, policia e Shkodrës ka vënë në pranga 3 persona, ndërsa është shpallur në kërkim atentatori. Mësohet se gjatë operacionit të koduar "Step by step" janë arrestuar vëllezërit Gilbert Toma 26-vjeç e Kleandro Toma 29-vjeç të dy banues në lagjen "Skënderbeg" në qytetin verior dhe Alfred Martini 20-vjeç, banues në fshatin Bardhaj, Shkodër. Mësohet se këta shtetas janë bashkëpunëtorë të autorit të krimit me iniciale K.S., i cili ndodhet në arrati. Sipas burimeve të mësipërme, dy vëllezërit Toma dhe i riu Martini rezultojnë se kanë ndihmuar ekzekutorin me mjete logjistike, armatime e deri tek strehimi. E ndërsa janë prangosur bashkëpunëtorët, ende nuk është zbardhur motivi i ngjarjes së rëndë të ndodhur pasditën e së mërkurës që shkoi në fshatin Grudë të njësisë administrative Gruemirë, ku mbeti i vrarë 32-vjeçari i njohur ndryshe si "Nardi i Bujtinave". Pas arrestimit të tre bashkëpunëtorëve ka reaguar vëllai i viktimës, Pavlin Polia, i cili në një prononcim për Dritare. net ka treguar se sapo ka marrë një



Viktima, Ferdinand Polia

hje për autorët, i lajmëruar nga policia. Pavlin Polia ka deklaruar ndër të tjera se autorët kanë ngatërruar objektiv. "Ne si familje përgëzojmë punën e shtetit. Nuk di

se kemi konflikte me asnjë të dyshuarit që me treguan. Ne besojmë se kanë ngatërruar personin, gjithësesi ne nuk bëhemi si ata sido që të jetë puna e kushdo që të jetë për-



Vëllai i 32-vjeçarit, Pavlin Polia

"Skënderbeg", Shkodër dhe A.M., 20 vjeç, banues në fshatin Bardhaj, Shkodër. Si dhe u bë shpallja në kërkim e shtetasit K.S., 27 vjeç dhe po punohet për gjetjen dhe kapjen e tij", thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë. Ndërsa sqarohet se "pas hetimeve intensive të kryera nën drejtimin e Prokurorisë Shkodër, rezultoi se shtetasit e lartpërmendur dyshohen se drejtpërdrejt me veprimet e kryera kanë mbështetur me logjistike dhe armatim, ndjekur, strehuar, organizuar dhe kryer në bashkëpunim këtë vrasje. Pas një pune intensive, ndjekjeje me metodat speciale të hetimit, u bë sigurimi i provave materiale dhe shkencore të cilat çuan në dokumentimin ligjor të kësaj ngjarje. Gjatë veprimeve hetimore u bë e mundur sekuestri i automjetit, i cili është përdorur nga autorët për ndjekjen e viktimës, orientimin e ekzekutorit, kryerjen e vrasjes, djegjen e motorit dhe largimin bashkë me ekzekutorin". Ndërkohë, mësohet se gjatë këtij operacioni janë sekuestruar 7 telefona, 17 fishekë të kalibrave të ndryshëm, targa të ndryshme automjesh shqiptare dhe të huaja dhe dokumente të ndryshme. Vijon puna për zbardhjen e plotë të ngjarjes si dhe mbi motivin e kësaj ngjarje dhe identifikimin e personave të tjerë të përfshirë. Materialet i kaluan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për veprën penale "Vrasje me paramendim e kryer në bashkëpunim" dhe "Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake".

PERSONAT E ARRESTUAR

1. Gilbert Toma, 26-vjeç
2. Kleandro Toma, 29-vjeç, të dy banues në lagjen "Skënderbeg" të qytetit të Shkodrës
3. Alfred Martini 20-vjeç, banues në fshatin Bardhaj, Shkodër.

NË KËRKIM

1. K.S., 27 vjeç (atentatori)

shirë në këtë ngjarje. Me shpresë që të zbardhet kjo ngjarje sa më parë, falënderoj ata që po na gjenden në këtë mort, që i mori jetën vëllait tonë." është shprehur Pavlin Polia. 32-vjeçari Nard Polia ishte i njohur si një nga njerëzit më përfaqësues të Thethit. Polia la pas gruan e tij shtatzënë dhe një fëmijë të vogël.

OPERACIONI I POLICISË

"Vijon puna për dokumentimin e plotë me prova ligjore të autorësisë së vrasjes së shtetasit N.P., më datë 20.03.2019. Finalizohet operacioni "Step By Step".

Në pranga tre bashkëpunëtorët kryesorë të autorit të dyshuar të vrasjes. Shpallet në kërkim autori i dyshuar. Gjatë paradites së sotme, pas një pune të mirëorganizuar nga ana e D.V.P. Shkodër, në bashkëpunim me forcat Operacionale të D.P.P. Shtetit Tiranë, dhe Prokurorisë dhe Rrethit Gjyqësor Shkodër, u bë finalizimi i operacionit "Step By Step" në lidhje me vrasjen e shtetasit N.P., ndodhur më datë 20.03.2019. Në këtë kuadër u bë ndalimi i shtetasve: G.T., 26 vjeç, banues në lagjen "Skënderbeg", Bashkia Shkodër; K.T., 29 vjeç, lindur dhe banues në lagjen

Avokatja dha dorëheqjen, dështon sërish seanca gjyqësore për çështjen "Shullazi"

TIRANË - Është shtyrë për të disatën herë seanca në Gjykatën e Apelit për Emiljano Shullazin dhe 4 të pandehurve të tjerë. Mësohet se avokatja mbrojtëse e Gilmano Danit, e caktuar më herët kryesisht, ka dhënë dorëheqjen për shkak se ndodhet jashtë shtetit për arsye shëndetësore. E gjendur në një situatë të tillë, gjykata shty seancën dhe zëvendësoi avokaten me një tjetër.



Pritet që seanca e radhës të mbahet më datë 8 prill. Ndërkaq, gjatë seancës së kaluar, gjykata vendosi të gjobisë avokaten e vendosur kryesisht, Eralda Brahim-

si me 100 mijë lekë dhe të referojë rastin në Dhomën e Avokatit, pasi u bë shkak për shtyrjen e gjyqit. Krimet e Rënda dënuan me 55 vite burg Emiljano Shullazin, Gilmando Danin, Endrit Qyja dhe Endit Zela si dhe Blerim Shullazin. Për Shullazin u dha 14 vite burg, ndërsa ai bashkë me bandën e tij akuzohen për krijim të grupit të strukturuar kriminal, gjobënie dhe kanosje për shkak të detyrës.



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 27 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 27.03.2019 (përfshirë TVSh-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	160 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	160 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	130 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOUNGE (6MG) 100 DSP 20 SSL	200 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,
1000 Tirana, Albania
Tel: +355 42 276 670

Ministria e Jashtme e Nigerisë kërkoi që të bëhej konsull nderi i Shqipërisë

Theksohet skandali, SHISH firmosi pastërtinë e indianit të shpallur në kërkim ndërkombëtar

Zbardhet letërkëmbimi mes SHISH e MEPJ për Nitin Sandesara

TIRANË

Skandali i dhënies së shpallur në kërkim ndërkombëtar për mashttrim financiar është thelluar më tej. "News 24" dhe "Gazeta Shqiptare" ka zbardhur letërkëmbimet mes Shërbimit Informativ Shtetëror dhe Ministrisë së Jashtme për dhënien e pëlqimit që njëri nga dy vëllezërit, Nitin Sandesara të bëhej konsull nderi i Shqipërisë në Nigeri.

"Në përgjigje të shkresës suaj numër 177437 datë 13 nëntor 2018, pas verifikimeve të kryera ju bëjmë me dije se Shërbimi Informativ Shtetëror është i mendimit që të jepet pëlqimi për emërimin e Z.Nitin Sandesara, konsull nderi i vendit tonë në Nigeri".

Në shkresën që SHISH i ka dërguar Ministrisë së Jashtme, nuk konstatohet asnjë problematikë në verifikimin e Nitin Sandesara, i cili kishte mashtruar bankat shtetërore indiane. Krahas kësaj, mësohet se shtetasi indian, i cili kishte marrë edhe shtetësinë shqiptare, nuk u pajis nga Ministria e Jashtme me pasaportë diplomatike.

Ministria e Jashtme, nga



Nitin Sandesara

ana e saj kishte marrë një kërkesë nga Ministria e Jashtme e Nigerisë, e cila kërkonte që Nitin Sandesara të bëhej konsull nderi.

"Kam kënaqësinë t'ju prezantoj z. Nitin Sandesara, i cili ka treguar interes për të shërbyer si Konsull Nderi i Republikës së Shqipërisë në Nigeri. Kjo kërkesë bazohet në përpjekjet e tij për të zgjeruar miqësinë midis dy shteteve, veçanërisht mbi

nevojën për të siguruar rritjen e investimeve dhe tregtisë midis dy vendeve nëpërmjet zyrës së konsullit të nderit në Abuja. Z. Nitin Sandesara dhe bashkëinvestuesi z. Chetan Sandesara janë të përkushtuar ndaj performancës në sektorin e naftës dhe gazit. Në bazë të performancës së kompanisë së tyre, ajo është vlerësuar nga ish-presidenti si një ndër 100 bizneset më

ARRESTIMI

Pak ditë më parë, policia prangosi shtetasin indian Hitesh Patel, i cili rezultoi se është kunati i vëllezërve Sandesara, i përfshirë, gjithashtu, në skandalin e mashtimit financiar në Indi. Pritet që brenda këtyre ditëve autoritetet indiane të sjellin në Tiranë kërkesën për ekstradimin e tij nga Shqipëria. Ndërkohë nga policia shqiptare nuk ka asnjë të dhënë nëse dy vëllezërit Sandesara janë ende në Shqipëri apo janë larguar pas publikimit të skandalit.

këtë skandal një gjykatë në Indi ka lëshuar urdhërrreste për ta. Por ndërsa ish-in shpallur në kërkim në Indi, shtetasit indianë jetonin të qetë dhe madje kishin investuar në Shqipëri.

Në shkurt të 2018-ës, dy shtetas indian morën nënshpërtësinë shqiptare. Sipas institucionit të Presidencës, i cili reagoi për këtë rast, ka qenë Ministria e Turizmit që ka bërë propozimin për dy shtetasit indianë, që të marrin nënshpërtësinë shqiptare. "News24" u interesua pranë Ministrisë së Turizmit në lidhje me këtë çështje, por kjo ministri nuk kishte një përgjigje për procedurën dhe verifikimet që janë kryer për dy vëllezërit Sandesara. Pak ditë më parë, policia prangosi shtetasin indian Hitesh Patel, i cili rezultoi se është kunati i vëllezërve Sandesara, i përfshirë gjithashtu në skandalin e mashtimit financiar në Indi. Pritet që brenda këtyre ditëve autoritetet indiane të sjellin në Tiranë kërkesën për ekstradimin e tij nga Shqipëria. Ndërkohë nga policia shqiptare nuk ka asnjë të dhënë nëse dy vëllezërit Sandesara janë ende në Shqipëri apo janë larguar pas publikimit të skandalit.

të suksesshme në Nigeri në vitin 2014 madje në një shkresë të policisë së Nigerisë theksohet se shtetasi indian ishte i pastër".

Sipas mediave indiane, vëllezërit Nitin dhe Chetan Sandesara kanë marrë deri në 1 miliard dollarë amerikanë kredi nga bankat shtetërore, duke i zhdukur përmes një rrjeti prej 300 kompanish offshore, të krijuara nga ata vetë. Për

"Nitin Sandesarën s'e pajisëm as me pasaportë diplomatike"

Në kërkim për pastrim parash, MEPJ i ndërpret indianit mandatin si konsull nderi

TIRANË - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dje deklaroi se ka ndërprerë mandatin si konsull nderi të Shqipërisë në Nigeri për shtetasin indian Nitin Sandesara, i cili është në kërkim për mashttrim në Indi. Sipas MEPJ, procedura e emërimit të z.Nitin Sandesara si konsull nderi i Republikës së Shqipërisë në Nigeri ka përfunduar në janar 2019. Në zbatimin e procedurës së emërimit janë marrë në konsideratë kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Konventën e Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore. Dhënia e nënshpërtësisë shqiptare dhe pajisja me pasaportë shqiptare e

SKANDALI

Referuar medias indiane "The Times of India", dy vëllezërit Nitin Jayantilal Sandesara dhe Chetankumar Jayantilal Sandesara, kanë marrë rreth 725 milionë deri në 1 miliard dollarë amerikanë kredi nga bankat shtetërore të Indisë, duke i zhdukur më pas përmes një rrjeti prej 300 kompanish "offshore", të krijuara prej vetë atyre. Për këtë skandal, Gjykata në Indi ka dhënë 4 urdhërrreste dhe është në kërkim të tyre. Ndërkohë që dy vëllezërit Sandesara dhe Hitesh Patel ishin ndër më të kërkuarit në Indi, në Shqipëri ata jetonin të qetë dhe kishin investuar në disa zona, duke pastruar paratë.

z. Sandesara nuk është procedurë, e cila ka kaluar nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, apo është në kompetencat e këtij institucioni. Për më shumë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jasht-

me, sqaron se, ndonëse ka të drejtën e pajisjes me pasaportë diplomatike dhe shërbimi, sipas VKM-së 335, dt. 2.9.1997, z. Sandesara nuk është pajisur, as me pasaportë diplomatike, as me pasaportë shërbimi. "Rasti i



artikular së fundmi i z.Sandesara me nënshpërtësi shqiptare, mund të cenojë imazhin dhe reputacionin e Institucionit të Konsullit të Nderit, por edhe atë të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe shtetit shqiptar në përgjithësi, pavarësisht faktit se veprimet e ndërmarra prej z. Sandesara janë në emrin e tij person-

al. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, informon se, ka të gjitha të drejtat ligjore për ndërprerjen e mandatit të konsullit të nderit. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme ka ndërprerë mandatin si konsull deri të Republikës së Shqipërisë në Nigeri për z.Nitin Sandesara me efekt të menjëhershëm", deklaroi MEPJ.

SHKURT

Veliu komandon Rehani Jaupajn në krye të policisë së Tiranës

TIRANË - Pas lirimit nga detyra të drejtorit të policisë së Tiranës Kastriot Skënderaj, i cili e mbante këtë post që nga shkurti i vitit 2018, do të zëvendësohet nga Rehani Jaupaj që mbante postin e zv/ drejtorit të Policisë së Shtetit. Ky i fundit mban gradën drejtues ilartë. Vendimi për lirimin nga detyra të Skënderaj u mor pak javë më parë nga kreu i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu pas përplasjes që ndodhi mes policisë dhe disa banorëve tek "Petro Nini". Deri në emërimin e Jubanit, drejtor i komanduar ishte Dhimitraq Ziu. Ndërkohë, janë firmosur edhe lëvizjet e para në Drejtorinë e Policisë së Tiranës pas komandimit të tij. Ardit Elmazi nga shef i komisariatit nr. 3 është emëruar të Komisarriati nr.6 në vendin e Pal Markut, ndërsa në vendin e tij shkoi Robert Loshaj.

Vrasja e Ravik Gurrës, Dhoma Kombëtare e

Avokatisë bojkot proceseve gjyqësore

ELBASAN - Elkzekutimi në qendër të Elbasanit, teksa qëndronte ulur në një kafe i avokati Ravik Gurra ka sjellë reagime të shumta. Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka vendosur ndërprerjen e shërbimit të avokatisë për tri ditë: të mërkurë, të enjte dhe të premte. "Dhoma Kombëtare e Avokatisë ka marrë vendim për të mos marrë pjesë në proces gjyqësor për tre ditë të mërkurë, të enjte, të premte. Dhe çdo avokat që thyen këtë rregull do të ndëshkohet me masë disiplinore", thuhet në njoftim. Avokati mbeti i vrrarë me armë zjarri mbremjen e datës 22 mars në një lokal të qytetit të Elbasanit.

Armë dhe kokainë me vlerë 100 mijë euro në makinë, në kërkim shqiptari

ITALI - Policia italiane ka shpallur në kërkim një shqiptar në Bolonja, identiteti i të cilit nuk bëhet me dije për veprat penale të trafikuar të drogës dhe armëmbajtjes pa leje. Ky veprim i autoriteteve italiane erdhi menjëherë pasi gjeti në makinën e shqiptarit 1.2 kg kokainë të pastër me vlerë 100 mijë euro. Kontrolli i saj u bë pasi ajo kishte qëndruar me orë të tëra e parkuar, sjellje kjo që rriti edhe më tej dyshimet tek agjencitë ligjzbatuese. Gjatë kontrollit, brenda makinës u gjet një pistoletë, e cila rezultonte e vjedhur.

Prurjet e emigrantëve arritën në 670 milionë euro ose 5.3% më shumë se viti 2017

Investimet e huaja në Shqipëri, arrijnë në 1 miliard euro

Pasuritë e paluajtshme, investimet 115 milionë euro

Investimet e huaja në Shqipëri vitin e kaluar kapën shifrën 1.02 miliardë euro. Të dhënat e fundit nga banka e Shqipërisë tregojnë se për gjithë vitin 2018, kompanitë e huaja investuan më saktësisht 1 miliardë e 21 milionë euro në ekonominë shqiptare, me një rritje prej 13.5 për qind krahasuar me një vit më parë. Megjithatë shifra totale e investimeve të huaja, maskon një dobësi strukturore. Vetëm një pjesë shumë e vogël e tyre, kanë shkuar në sektorin e manufakturës, i cili zgjeron bazën prodhuese të ekonomisë. Të dhënat e detajuara tregojnë se pjesa dërrmuese e investimeve nga jashtë kanë qenë vetëm në katër sektorë, që janë; energjia, industria nxjerrëse, pasuritë e patundshme dhe sektori financiar.

INVESTIMET

Për vitin 2018 kompanitë e huaja investuan 467 milionë euro në prodhimin e energjisë dhe sektorin e gazit, pjesa dërrmuese e të cilave vjen nga gazsjellësi TAP dhe Kaskada e Devollit. Në industrinë nxjerrëse, veçanërisht naftë dhe miniera u investuan 171.1 milionë euro, ndërsa në aktivitetin e pasurive të paluajtshme 115 milionë euro. Të huajt duket se po blejnë gjithmonë e më shumë prona të patundshme në Shqipëri, veçanërisht në Tiranë dhe zonat breqendore. Banka e Shqipërisë shi dhe detajon se sa prej këtyre investimeve vijnë nga individë të huaj që blejnë prona në Shqipëri dhe sa vijnë nga bizneset, por në total vitin e kaluar të huajt investuan 115 milionë euro në aktivitetin e pasurive të paluajtshme, edhe ky një rekord historik. Sipas statistikave të bankës qendrore fluksi i investimeve është përqendruar kryesisht në sektorin e energjisë dhe gazit si dy sek-



Flukset hyrëse të IHD sipas akt. ekonomik (milion Euro)		VIETORI				
Përshkrimi i tregutit	2014	2015	2016	2017	2018	
Përshkrimi i tregutit						
Huajtues, pyjet dhe pyllorësi	-2.8	0.0	-4.4	5.2	0.1	
Industria nxjerrëse	504.4	322.8	157.6	236.2	171.1	
Industria përpunuese	75.0	130.1	565.2	407.6	407.0	
Energjia elektrike, gasi, dhe furnizimi me ujë	24.3	3.6	1.4	20.6	30.0	
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe mot.	45.2	23.5	18.6	8.6	28.7	
Transporti dhe magazinimi	-4.7	96.0	12.4	-14.6	-0.4	
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	0.0	0.0	-1.0	-15.0	-29.6	
Informacioni dhe komunikimi	89.2	40.8	-15.7	-24.1	-37.5	
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	36.4	80.4	72.4	111.8	103.6	
Aktivitetet të pasurive të paluajtshme	51.4	24.4	33.1	42.2	115.5	
Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	14.9	4.8	7.2	82.6	90.9	
Shërbime administrative dhe mbajtëse	4.3	1.6	6.9	24.8	46.0	
Arsimimi	0.8	1.0	0.1	0.6	0.7	
Shërbimet e aktivitetit të punës sociale	0.0	0.0	-3.9	-2.8	3.6	
Arta, argëtim dhe gjëdhije	7.5	-3.5	11.9	12.6	-0.4	
Aktivitetet të tjera shërbimi	-0.1	0.2	-1.4	0.5	0.2	
Aktivitetet të organizatave dhe organizimave ndërkombëtarë	9.1	32.4	24.0	0.0	0.0	
Të tjera për anëtarë konfidencalet	31.1	112.7	0.0	0.0	0.0	
Viteti i referencës	809.5	890.3	942.6	899.7	1,022.2	

toret më të pëlqyer për investitorët, ndërsa bujqësia dhe hoteleria nuk kanë thithur ende kompani të huaja. Peshë të konsiderueshme vijojnë të mbajnë dy projektet në energji,

SHQIPËRIA "E PREFERUAR" PËR QËLLIME BIZNESI

Në vetëm dy muajt e parë të këtij viti, Shqipëria ka pasur 12 mijë e 380 vizitues me qëllime biznesi dhe profesionale. Referuar INSTAT, vihet re një rritje e ndjeshme me rreth 30 për qind krahasuar me vitin e kaluar. Numri i vizitave me po të njëjtin qëllim për dymujorin e parë të 2018-ës ka qenë 9 mijë e 632. Shifrat flasin pozitivisht për mundësi të reja biznesi nga investitorë shqiptarë apo të huaj. Nga ana tjetër, lëvizjet e shtetasve me qëllime të tjera si pushime apo ndalesa transit kanë qenë më të vogla në numër se sa në dymujorin e parë të 2018. Një rritje të vogël ka pasur vetëm në vizitat me qëllime fetare dhe ato shëndetësore.

Ish-ministri Ahmetaj: Super ecuri e investimeve

Ish-ministri i Financave Arben Ahmetaj ka komentuar raportin e Bankës së Shqipërisë në lidhje me investimet. "Super ecuri e investimeve të huaja direkte në vitin 2018, duke kapërcyer për herë të parë nivelin mbi 1 miliardë euro. Ky është një tjetër tregues pozitiv për mbijlljen e suksesshme të vitit që lamë pas, në terma të treguesve ekonomikë. Në tremujorin e fundit të 2018, fluksi i investimeve të huaja direkte arriti 273 milionë euro, ose 19% më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Përqendrimi kryesor është në sektorin e energjetikës (në masën 59%), të hidrokarbureve (në masën 21%) dhe ndërmjetësimit financiar (në masën 3%). Në total, për vitin 2018 investimet e huaja kapën vlerën rekord 1.02 miliardë euro, ose 14% më shumë se totali i vitit 2017 (rreth 900 mln euro). Rritja e besimit tek ekonomia shqiptare është fakt, por është dhe një alert i rëndësishëm për nevojën e vazhdimtë të konsolidimit fiskal dhe përsheptimit të rritjes ekonomike, për të ruajtur performancën pozitive të treguesve" shkruan Ahmetaj në FB.



jetikë, siç është ndërtimi i gazsjellësit TAP si dhe ndërtimi i hidrocentralit në lumin Devoll.

ar edhe rritje të remitancave. Thënë ndryshe familjet shqiptare kanë përfutur më shumë para nga të afërmit e tyre në emigrim. Duke ju referuar të dhënave nga Ban-

Nisma e qeverisë, lehtësi për biznesin

Zv.ministri Haxhi: Program për 'Përkujdesjes ndaj investitorëve'

Program 'Përkujdesjes ndaj investitorëve' i cili parashikon mbështetje dhe asistencë teknike për zhvillimin e sipërmarrjes do të shtrihet në 8 bashkitë kryesore të vendit. Këtë e ka bërë të ditur zv.ministri i Financave dhe Ekonomisë, Elton Haxhi gjatë vizitës së tij në një kompani private, e fokusuar në prodhimin e timonëve dhe aksesoreve të tjerë për industrinë automotivë. Sipas Haxhit, përmes këtij programi i cili po zbatohet tashmë që prej vitit 2016, do të asistohen rreth 60 sipërmarrje në sektorët e teknologjisë së informacionit, agropërpunimit si dhe industrisë automotivë. "Ky program do të shtrihet në 8 bashki kryesore dhe planifikohet që të kontaktohen dhe të asistohen rreth 60 biznese, që i përkasin tre sektorëve më sipër. Asistenca ka të bëjë me biznese të



cilat kanë filluar të investojnë në Shqipëri dhe të identifikohen problematikat që ata hasin në mënyrë që të adresohen në institucionet që kanë

përgjegjësinë për t'i zgjidhur këto problematika", deklaroi Haxhi. Ndërkohë, shtoi më tej se si rezultat i përjashtimit nga TVSH-ja e makinerive dhe pajisjeve është bërë një lehtësim prej 0 miliardë lekësh gjatë këtyre 5 viteve të fundit në rang kombëtar. "Nga përllogaritjet që kemi bërë ndaj biznesit, në përgjithësi në rang kombëtar, për 5 vitet e fundit është bërë një lehtësim prej 9 miliardë lekësh vetëm nga përjashtimi nga TVSH-ja i makinerive dhe pajisjeve për investimet në biznese të ngjashme."-tha Haxhi.

Shitje me Ankand te dyle nga Studio Permbartore L.D.C

"Trulli + ndërtesa" me nr. pasurie 286/S/1, vol.3, faqe 36, Zona Kadastrale, 3666, me sipërfaqe totale 300 m², regjistruar ne Z.V.R.F.P. Tirane. Çmimi fillestar per shitje eshte 1.800.000 Leke.

Data e shpalljes 27.02.2019

Data e zhvillimit 28.03.2019 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e Studios Permbartore L.D.C me adrese Rruga "Myslym Shyri" Vila 8/1, kati 1 Tirane.

Kompania me kapital shqiptar e futuri me "Air Albania" ka arritur të marrë certifikatat dhe ka regjistruar numrin e flamurit shqiptar pranë Autoritetit të Aviacionit Civil në Shqipëri. Belinda Balluku, Ministre e Infrastruktura dhe Energjisë tha gjatë një takimi me studentët të ekscelencës se certifikimi i kompanisë së parë ajrore me kapital shqiptar është bërë konform standardeve europiane. "Air Albania", e cila është certifikuar, ka marrë edhe numrin me flamurin shqiptar të regjistrimit, duke përmbyllur të gjitha proceset certifikuese konform standardeve evropiane. "Tashmë pritet që "Air Albania" të kalotë disa procedura certifikimi edhe nga autoritet europiane për të nisur fluturimin me flamurin shqiptar. Duke folur për strategjinë e zhvillimit të hapësirave ajrore, Balluku u tha studentëve se qeveria po punon për të çuar përpara projektin e Aeroportit të Vlorës. "Aviacioni Civil ka muajt që punon, unë jam e përfshirë në atë projekt

"Air Albania" certifikohet nga Aviacioni Civil



gjithashtu, jo vetëm nga pozicioni i ri, por edhe më parë dhe sot, akoma më shumë e kam dhe nxitje për ta çuar përpara, projektin e aeroportit international të Vlorës."-tha Balluku. 10 stu-

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përmbartimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dyle për pasurinë:

1- Njesi, me sipërfaqe 64.10 m², e ndodhur në Lagjia Barikade, Berat, në Zonën Kadastrale 8501, Numri i Pasurisë: 8/147-N1, Vol. 22, Faqe. 87, ne pronesi te Dorjana Gjoroveni, Endrit Gjoroveni, Beshtir Gjoroveni. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 4,953,648 (kater milion e nenteqind e pesedhjet e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) LEKË.

Ankandi i dyle per pasurine e mesiperme zhvillohet me date 19.04.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrrës se përbaruese gjyqesore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1,kf.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

Në ndihmë të grave, fëmijëve e kategorive në nevojë

Fondi Social, Manastirliu: Financim shërbimeve sociale në çdo bashki

Me buxhetin e shtetit do të financohet ngritja dhe zgjerimi i shërbimeve sociale për gratë, fëmijët në vështirësi, të moshuarit dhe të gjithë kategoritë në nevojë, nëpërmjet Fondit Social, një mekanizëm i ri financiar që garanton shërbimet sociale në çdo bashki. Deklarata u bë nga ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, gjatë vizitës në një qendër sociale që mbështet viktimat e trafikimit dhe të dhunës, ku lajmëroi vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave, për Fondin Social. "Fondi Social është mekanizmi financiar që tashmë është miratuar nga

OGERTA MANASTIRLIU

Ogerta Manastirliu, gjatë vizitës në një qendër sociale që mbështet viktimat e trafikimit dhe të dhunës, ku lajmëroi vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave, për Fondin Social. "Fondi Social është mekanizmi financiar që tashmë është miratuar nga

Këshilli i Ministrave, për t'u vendosur në funksion të gjithë bashkive, nëpërmjet planeve sociale që ato do të miratojnë, për të ndërtuar

dhe ngritur shërbimet sociale në territor, për të gjithë grupet në nevojë", - tha Manastirliu. Prej të paktën 15 vitesh, krijimi i Fondit So-

cial ka qenë kërkesë e vazhdueshme për ofrimin e shërbimeve sociale në territor. Shërbimet komunitare të ngritura në vite nga bashkitë e vendit kanë qenë të fragmetarizuara dhe jo të shpërndara drejt gjeografikisht. Nga analiza e fundit e bërë, rezultojnë se në disa bashki nuk ofrohet ende asnjë shërbim social në territorin e tyre. Vendimi i fundit i qeverisë parashikon metodologjinë e re të financimit të shërbimeve sociale në territor nga buxheti i shtetit, procedurat dhe kriteret se si do të përllogariten fondet e nevojshme që bëjnë



realitet këto shërbime, kudo ku ka nevojë për to. Kriteri kryesor është nevoja reale për këto shërbime, aty ku sot mungojnë, ose janë të pakta. "Metodologjia e financimit që Këshilli i Ministrave ka miratuar do të bëjë të mundur që çdo bashki të ngrejë shërbime sociale në territor për grupe në nevojë dhe të

financojë jo vetëm këtë vit, por në mënyrë të vazhdueshme, duke filluar në vitin e parë me 90 % të financimit, vitin e dytë 60 % të financimit, në mënyrë që të rritet angazhimi i strukturave vendore për financimin e këtyre shërbimeve", -tha Manastirliu.

Kryeministri: Nisin përgatitjet për kartën e studentit. Investim masiv për arsimin

Voltiza Duro

'Pakti për Universitetin', Rama prezanton portalin e dedikuar për transparencën

Studentët: Qeveria nuk jep zgjidhje, do të rinisim protestat

Për të garantuar transparencë në universitet, tashmë në dispozicion të studentëve do të jetë portali utrasparenca.al, ku do të publikohet gjithçka që ka lidhje me buxhetin në institucionet e arsimit të lartë. Ditën e djeshme, kryeministri i venditi Edi Rama, prezantoi këtë portal që e cilësoi si një instrument garancie. "Besoj që në këtë rast ne kemi vënë në dispozicion të universiteteve një instrument garancie, që duhet të përdoret nga universitetet dhe do të monitorohet nga qeveria për aq sa i takon qeverisë, sepse kjo nuk është detyrë e qeverisë, por e universiteteve. Pika më delikate e çdo organizate që shpenzon, që është buxheti të publikohet në të gjithë elementët e vet, jo vetëm si buxhet vjetor, por edhe si buxhet afatmesëm. Portal jep mundësinë e një pasqyre të dhënash shumë të detajuara", -tha Rama në fjalën e tij.

INVESTIMET

Kreu i qeverisë bëri me dije, gjithashtu, se brenda këtyre dy viteve do të investohet masivisht thuasje në çdo universitet, si në infrastrukturë, ashtu edhe në laboratorë. "Deri në fillim të vjeshtës do hartojmë planin konkret të investimit të projekteve dhe për të bërë projekte aty ku na mungojnë. Do të kryejmë investimin më të madh se sa është investuar në 30 vjet për infrastrukturën, laboratorët për universitetin. Brenda dy viteve një kantier në çdo universitet dhe paralelisht po punojmë me infrastrukturën e konvikteve", - tha Rama.

PUNËSIMET E EKSELENTËVE

Kryeministri nuk harroi



Dje gjatë takimit të kryeministrit Edi Rama në prezantimin e portalit

të fliste edhe për punësimet e studentëve ekselentëve. Ai tha se pas 300 të parëve që tashmë janë pjesë e administratës, shumë shpejt do të bëhet edhe thirrja e dytë për aplikim. "Kemi filluar me 300 të parët, ata janë pjesë e administratës. Po përgatitet thirrje e dytë dhe faktikisht, të gjitha vendet e lira të punës në administratën e punës, por edhe ato që nuk janë pjesë e shërbimit civil do të jenë në dispozicion të atyre që kanë përfunduar me 9-10. Është një rrugë e hapur tani, tërësisht objektive. Ankesat që kemi pasur janë adresuar të gjitha.

Kemi bërë një pastrim që nuk mjafton, do të shkojmë më thellë. Thirrja do të jetë për më të mirët. Nuk do të ketë rrugë për të tjerë që ti kalojnë", -bëri me dije kreu i ekzekutivit.

KARTA E STUDENTIT
Kryeministri Edi Rama tha se përgatitjet kanë nisur edhe për kartën e studentit. Sipas tij, faza e parë e implementimit do të nisë me Bashkinë e Tiranës. "Kanë nisur përgatitjet, fazën e parë të implementimit do ta nisim me Bashkinë e Tiranës. Mbi atë model do të shtrihemi edhe në qytete të tjera universitare, duke garantuar një ndërveprim të

kartës së studentëve shqiptarë dhe kartës evropiane të studentëve", -tha kryeministri.

REAGIMI I STUDENTËVE
Menjëherë pas takimit të kryeministrit, lëvizja "Për Universitetin" ka paralajmëruar protesta masive shumë shpejt nga ana e studentëve. "Në këto kushte, studentëve nuk u mbetet veçse të vazhdojnë me shumë këmbëngulje dhe intensitet procesin e riorganizimit në bazë fakulteti për të nisur së shpejti një zinxhir protestash masive. Kjo qeveri dhe ky sistem politik gjuhën

INVESTIMI

"Deri në fillim të vjeshtës do hartojmë planin konkret të investimit të projekteve dhe për të bërë projekte aty ku na mungojnë. Do të kryejmë investimin më të madh se sa është investuar në 30 vjet për infrastrukturën, laboratorët për universitetin. Brenda dy viteve një kantier në çdo universitet dhe paralelisht po punojmë me infrastrukturën e konvikteve", -tha Rama.

PARALAJMËRIMI I STUDENTËVE

"Në këto kushte, studentëve nuk u mbetet veçse të vazhdojnë me shumë këmbëngulje dhe intensitet procesin e riorganizimit në bazë fakulteti për të nisur së shpejti një zinxhir protestash masive. Kjo qeveri dhe ky sistem politik marrin vesh vetëm gjuhën e fuqisë dërrmuese të shumës së studentore dhe qytetare", -thonë studentët.

e fuqisë dërrmuese të shumës së studentore dhe qytetare", -thotë në reagimin e saj lëvizja "Për universitetin". Kjo e fundit shtoi se qeveria nuk do t'u japë zgjidhje problemeve të tyre. "Gjatë takimit propagandistik të radhës, kryeministri Rama u kujtoi studentëve se si qeveria nuk ka ndër mend t'u japë zgjidhje problemeve të tyre. Në vend të uljes së tarifave në të gjitha nivelet, ai propozoi investime imagjinare në universitete. Pa plan, pa shifra e pa afate. Në vend të demokratizimit të universiteteve duke u dhënë fuqi të barabartë studentëve dhe pedagogëve, ai

ripohoi pushtetin e bordeve të kontrolluara nga qeveria. Në vend të fuqizimit të studentëve në kontrollin e pedagogëve abuzues - nga marrja e shitja e detyruar e librave të plagjiaturat - ai premtoi se do të fusë ruspën shtetërore në universitet. Jo për të ndryshuar situatën, por për të zëvendësuar bajraktarët që nuk kontrollojnë me bajraktarë të bindur. Në vend të rritjes së buxhetit të shtetit për universitetet publike, ai u kërkoi këtyre të fundit të themelojnë firma tregtare për të mbuluar vështirësitë financiare", - theksojnë studentët në reagimin e tyre.



Kushtet në shtëpinë e nënës me 4 vajza

Nëna e 4 fëmijëve: Njëren nga vajzat e kam në jetimore, kërkohet shtëpi e punë

Voltiza Duro

A të mund ta gesh përditë rrugëve të kryeqytetit, duke lytur apo duke kontrolluar kazanëve të mbeturinave për t'u siguruar bukën e gojës fëmijëve. Ajo që 15 vite më parë, nisi si një martesë e lumtur mes dy të rinjsh, përfundoi një makth, që vetëm divorci mund ta zgjidhte. Sot ajo është 34 vjeçe e në një rrëfim për 'Gazeta Shqiptare', nëna e 4 vajzave të mitura tregon dramën e jetës së saj e kalvarin e gjatë të vuajtjeve që ka kaluar. Gruaja me inicialet S. M. rrëfen se ish-bashkëshorti e ka dhunuar në forma nga më të ndryshmet, madje i ka thyer dhëmbët dhe e ka goditur me tullë në kokë. Gjithçka që ajo kërkon është një dhomë që mos të paguajë qiranë e shtëpisë dhe një punë që të mund të sigurojë jetën e vajzave të saj.

Sa vjeç jeni dhe sa fëmijë keni?

Quhem S. M. e jam 34 vjeçe. Kur kam qenë 19 vjeç jam martuar me njeriun që e doja aq shumë, pas një viti kam sjellë në jetë fëmijën e parë, vajzën e madhe që sot është 14 vjeç. Gjithashtu, kam edhe 3 vajza të tjera, 6, 5 dhe 3 vjeç.

Po bashkëshorti juaj ku ndodhet?

Në korrik të 2018-ës jam divorcuar përfundimisht me bashkëshortin, dhe që atëherë jetoj në një shtëpi me qira së bashku me vajzat.

Si ishte martesja juaj më parë?

Në vitet e para të martesës, kalonim mirë, punonim që të dy. Pavarësisht kushteve të vështira ekonomike, arrinim që së bashku të siguronim bukën për vajzat e përqipeshim që të mos u mungonte asgjë. Jetonim në Yzberisht, por shtëpia ishte e vjetër dhe u rrënua, sepse ishte ndërtuar me baltë. Pas kësaj u transferuam në një barakë dhe aty nisën gjithë problemet.

Çfarë iu shty drejt divorcit?

34-vjeçarja: Burri më ka thyer dhëmbët e më ka goditur me tullë në kokë

"Torturat ma bënë jetën ferr, kam tentuar të vras veten"



34 vjeçarja duke folur për 'GSH'

MARTESA

Në vitet e para të martesës, kalonim mirë, punonim që të dy. Pavarësisht kushteve të vështira ekonomike, arrinim që së bashku të siguronim bukën për vajzat e përqipeshim që të mos u mungonte asgjë. Jetonim në Yzberisht, por shtëpia ishte e vjetër dhe u rrënua, sepse ishte ndërtuar me baltë. Pas kësaj u transferuam në një barakë dhe aty nisën gjithë problemet.

Para dy vitesh bashkëshorti filloi të pinte shumë alkool, nuk punonte më dhe rrinte i dehur gjithë kohën. I ndikuar edhe nga pija, filloi dhunën jo vetëm ndaj meje, por edhe ndaj fëmijëve. Përveç gjendjes së mjerueshme ekonomike, arsyeja kryesore e ndarjes sonë ishte dhuna që u bë e padurueshme. Nuk mund të

jetojë një njeri me frikë kur shikon burrin që hyn te dera. Kisha frikë për veten, por më shumë kisha frikë për fëmijët. Nuk e shikoja dot kur vinte dorë mbi vajzat, më dhimbte shpirti. Përqipësia që ta ndaloja, por më rrihte edhe mua, na godiste me çfarë të kishte në dorë. Unë u mundova shumë që ai të kthehej si më parë, por nuk

bëri asnjë tentativë për të ndryshuar. Kështu që rruga e vetme ngeli divorci.

Cilat ishin disa nga format e dhunës që ish-bashkëshorti ushtronte ndaj jush?

Përveç se më godiste me shpulla e grushta, arriti deri aty sa më theu edhe dhëmbët. Madje ka patur një rast që më ka goditur edhe me tullë në kokë. Pas goditjes përfundova në spital nga dhuna e njeriut që doja aq shumë. Në ato momente ndihesa si njeri pa njeri, krejtësisht e braktisur, torturat ma kishin bërë jetën ferr. Madje pas kësaj, një ditë, tentova të vras veten me bar mui. Nuk po duroja dot më, nuk arrita as të mendoja. Edhe pse më erdhi keq për vajzat që do i lija jetime, piva ilaçet. Nuk mbaj mend më tej, por di që më gjeti nëna

FORMAT E DHUNES

Përveç se më godiste me shpulla e grushta, arriti deri aty sa më theu edhe dhëmbët. Madje ka patur një rast që më ka goditur edhe me tullë në kokë. Pas goditjes përfundova në spital. Isha shumë e tronditur! Nuk e kisha imagjinuar asnjëherë që të përfundoja në spital nga dhuna e njeriut që doja aq shumë.

shpëtuar nga druri. Por gjendja ekonomike është e mjerueshme. Nga shteti marr vetëm 60 mijë lekë të vjetra, në një kohë që 80 mijë kam qiranë e shtëpisë, pasi u largova nga shtëpia e nënës, nuk më mbante dot. Tani më duhet të dal të lyp, ose të kontrolloj nëpër kazanët e plehrave me shpresë se gjej ndonjë kanaçe ose troba që i marr i shes me cmim të lirë. Vajzat e mia kanë bukë thatë të lagur me ujë e sheqer, e në rastet më të mira iu jap ndonjë pjatë makarona ose oriz. Madjenjë nga vajzat, atë që është 5 vjeç e kam lënë në jetimore në Sauk.

Pse e latë në jetimore një nga vajzat?

Shpirti më dhemb, por nuk e mbaj dot, s'kam si ta mbaj, ca ti jap për të ngrënë, të paktën aty e mbush barkun me bukë. E kam lënë kur kam qenë ende me burrin. Shkoj e takoj çdo fundjavë, e nuk i çoj dot një çokollatë. Ajo më shikon, qan e më lutet që ta marr të shtëpia bashkë me motrat e saj.

Çfarë do të doje ndryshe në jetën tënde?

Kërkohet vetëm një dhomë që mos paguaj qiranë, e një punë, asgjë më shumë. Të rriten edhe vajzat e mia si gjithë të tjerët, se boll kanë parë vuajtje në moshë të vogël. Të kem mundësi t'u jap për të ngrënë, t'u blej rruba e çanta për shkollë, mos ndihen keq para shoqeve. Nëse do të kem punën, do të marr edhe vajzën 5 vjeçare që kam lënë në jetimore, s'mund ta lej më aty. Ju lutem të gjithëve, kush ka mundësi të më ndihmojë sadopak e të vejë dorën në zemër për ato vajza.

Pasi morët urdhër mbrojtjeje, ku shkuat për të jetuar?

Pasi mora urdhrin e mbrojtjes, mora vajzat e shkova të jetoja te shtëpia e nënës sime, edhe pse ajo është shumë keq ekonomikisht e iu bëra barrë. Por ish-bashkëshorti prapë erdhi aty e madje më mori me dhunë sërish për te baraka. Arrita të shpëtoja në momentin që ai ra në burg për armëmbajtje pa leje. Kur doli nga burgu, procedurat e divorcit ishin drejt fundit dhe nuk tentoi më të më dhunonte.

Si është jetesa jote pas divorcit? A merr ndonjë ndihmë nga shteti?

Jam më e qetë, sepse kemi

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve, tre muaj kohë për të plotësuar dosjen

Trashëgimtarët e ish-të dënuarve politikë, që nuk kanë marrë dëmshpërblimin e kështit të tretë duhet të dorëzojnë dokumentet në Ministrinë e Financave. Janë në total 1 mijë përfitues, dosjet e të cilëve janë shqyrtuar nga Drejtoria e Pagesave nga janari deri në tetor të vitit të shkuar. Burime zyrtare nga ministria bëjnë të ditur se trashëgimtarët njihen si përfitues, por kanë mangësi në dokumentacion. "Gazeta Shqiptare" publikon sot listën e përfituesve me të gjitha detajet për çdo dosje. Në listën e publikuar shënohet me "V" në rastet kur dokumenti është në rregull, me "X" kur është gabim dhe është kolona bosh kur dokumenti nuk është paraqitur.

DOKUMENTET

Të gjithë trashëgimtarët e ish-të dënuarve duhet të

Lista e re / Ish-të përndjekurit, 1 mijë trashëgimtarët që marrin paratë

Dokumentet dorëzohen në Ministrinë e Financave

sigurohen pranë bankës në të cilën kanë hapur llogarinë që llogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shuma e dëmshpërblimit kthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të panevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rast

et kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me një gërmë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në cer-

tifikatën e lëshuar nga gjendja civile. Në raste se ka transkriptime të gabuara gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës, apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile.

Ligi parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapitale pa gjyq është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative e lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzis-

tojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i interesuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave.

TRASHËGIMTARËT QË MARRIN PARATË

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUN GUT FAMILJAR	DESH MI TRASHIG-MIE	PROKURE
XHEVRRIE	MUZHAGI			X		V	V	V	P
SHEFKI	DASHI			V	V				V
HAZIS	DASHI			X					P
VITORI	KAPO			V					X
HARIKLA	BALTUVANI					V	V	V	
GLIOERIA	ELZI			V	V				
KRISANTHI	MELA			V	V				
VANGJEL	BALTUVANI			V	V				
TEKI	ILIAS			X					P
FEIM	ILIAS			V	V				
FLUTUR	QOSE			V	V				
DIANA	BARDHI			X	X				V
TATJANA	FRASHERI			V	V				
PEMBE	CAKO			V	V				
NINI	REXHEP			X					P
SHPETIM	GURRA			X	X				
MARK				V	V	V	V	V	
GYSTE	PALUCA			X	X				
NDOC	KOLA			X	X				
PRENG	KOLA			X	X				
	LULJETA	KOLA		X					P
	ARBEN	KOLA		X					P
	FLORA	KOLA		X					P
	DAVA	KOLA		X					P
SOFIJE	LAJTHIA					V	V	V	
	EDMOND	LAJTHIA		V	X				
	ARDIANO	LAJTHIA		V	X				
	ILIR	LAJTHIA		V	X				
VERGJINUSH	GJONA			V	X				
VELI	COLLAKU					X	X	V	
	TRITAN	COLLAKU		X	X				
	ANA	CILIKI		X					P
	MIRGETA	THACI		X					P
	MIMOZA	TUFA		X					P
	SAIMIR	COLLAKU		V	X				V
ALI	COLLAKU			V	X				
VALENTINA	BILISHAJ			V	X				
FATMIRE	KURTI			V	X				
AGUST	COLLAKU			V	X				
ENGJELL	COLLAKU			V	X				
LUMTURI	HIBO			V	X				
BUKURRIE	MEHMETI			V	V				
HATXHE	MEHMETI			V	V				
DIANA	MEHMETI					X	X	X	
HAJRIJE	RUKAJ					V	V	V	
MEM	RUKAJ			V					P
FERIDE	RUKAJ			V					P
XHIKE	RUKAJ			V					P
DIZDAR	RUKAJ			V	V				V
SAFIJE	KULLA			X					P
MIDE	HIMA			X					P
FITNETE	MERA			X					P
DILAVER	KULLA			V	V				V
NEIME	JENISHERI					V	V	V	
FEZILET	SPAHIU			X	X				
MINERVA	JENISHERI			X	X				
SANJIE	JENISHERI			V	V				

EMER	MBIEMER	EMER	MBIEMER	KOPIJE TE LETER NJOFTIM	NUMER PERSONAL LLOGARIA BANKARE	CERTIFIKATE VDEKJE	CERTIFIKATE TRUN GUT FAMILJAR	DESH MI TRASHIG-MIE	PROKURE
XHEVAHIRE	TAKE					V	V	V	
BALLKEZE	SPAHIU	TATJANA	BERXOLLI	V	V				
NADIRE	DOKO					V	V	V	
		ILIR	DOKO	V	X				
		AGRON	DOKO	V	X				
		ADRIAN	DOKO	V	V				
MYZEJEN	HADERI					V	V	V	
		FATOS	HADERI	V	V				
		VALENTINA	HOXHA	V	V				
		ADRIAN	HADERI	V	V				
AGIM	PLAKU			V	V				
MIFARET	COMO			V	V				
AFERDITA	LAIAS					V	V	V	
		GENTI	CANO	V	V				
		ALMA	CANO	V	V				
FATBARDHA	TAHIRI			V	V				
ERANDI	KOLA			V					P
DINORA	KOLA			V	X				
ROZALIA	XHIMITIKU					V	V	V	
GUIDO	XHIMITIKU					V	V	V	
		EDMOND	XHIMITIKU	V					P1
		ROZALBA	PALL	V					P1
		SERXHO	XHIMITIKU	V	V				V1
KARMEN	XHIMITIKU			V	V				V
EZIO	XHIMITIKU					V	V	V	
		MILTO	XHIMITIKU	V					P
		Aleksander Mate	XHIMITIKU	V					P
		Leonarda Klau	XHIMITIKU	V					P
FIDARIE	ZERIA			V	V				V
NAMIJE	CANI			V					P
XHAFIDE	CANI			V					P
						V	V	V	
PRENA	GIJOKA					V	V	X	
NDREC	GIJOKA			V	V				V
						V	V	V	
SOFIJA	BELLO					V	V	V	
MIHALAQ	BELLO					V	V	V	ZV
		ORNELA	BELLO	V	X				
		BRIKENA	BREGU	V	X				
THOMA	BELLO			V	V				
KOCO	BELLO			V	V				
ASTRIT	SINANAJ					V	V	V	
		SHEZAIR	SINANAJ			V	V	V	
		FLORIE	ZYBERI	V					P
		GHINOVEFA	SINANAJ	V					P
		ZENEL	SINANAJ	V					P
		LINDITA	MUHAMETA	V					P
		LIJAN	SINANAJ	V					P
		MIMOZA	BRAPAJ	V					P
		LULZIME	SINANAJ	V	X				V
HYSEN	XEBA					V	V	V	
		LAVDOSH	XEBA	V	V				
FADIL	XEBA			V	V				
MEHMET	XEBA			V	X				
NOVRUZ	XEBA			V	V				

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ
CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET
KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR
QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com
BW

FALAS



Rrëfihet piktori: Do pikturoja dhe në Mars, "Gjurmë" simbolika e veçantë e artit tim

Amarildo Ruçi:

Punoj me gishta mbi telajo, e kuqja nuk më ndahet kurrë

"Jam i lumtur për çdo gjë që më ka ofruar jeta"

Egla Xhemali

Artisti duhet të shikojë botën me të gjitha ngjyrat madje duhet të kapërcej shikim edhe përtej asaj që syri sheh". Kështu e nis rrëfimin e tij për "Gazeta shqiptare" piktori Amarildo Ruçi. Ekspozita "Gjurmë" një konglomerat emocionesh, ndjesish dhe ngjyrash ka hapur dyert në muzeun kombëtarë për të gjithë artdashësit më datë 22 Mars dhe ka përfunduar më datë 25. Një përjetim i jashtëzakonshëm përgjatë këtyre ditëve, ku njerëz të ndryshëm janë afeksionuar me punët e piktorit. Ruçi ka sjellë një ndërthurje rrymash në ekspozitën e tij, ku dhe emri nuk është rastësisht gjurmë. "Gjurma" ka të bëjë me përjetimet e piktorit tek sa lë shenja në telajo me gishta, si dhe me gjurmën që ka lënë arti tek ai. Më tej, tek rrëmon në kohë Amarildo na tregoi fillesat e pasionit të tij më të madh, vendin që do zgjidhte për prehen e shpirtit pas një dite "uragan", copëza momentesh nga ditët e tij të zakonshme, si dhe ndryshimet që do të bënte po të kthehej pas në kohë. Arti u përket të gjithë atyre që janë të lidhur ngushtë me të, që bashkojnë imagjinatën dhe punojnë fort për të lënë shenja që pluhuri i kohës nuk arrin t'i mbulojë. Edhe gjurma e Amarildo Ruçit duket se do ngelet gjatë në kujtesë dhe jo vetëm.

Ndjesia që ke kur lyhesh me bojëra teksa pikturon?

Ndjesia që marr nga bojërat është shumë e fortë. Emocioni i pikturës fillon që në momentin që bëj përzjerjen e bojërave, të cilën e bëj me duar dhe, siç dihet, kanë ndjeshmëri të lartë që përcillet fillimisht tek unë e më pas gjatë punimit të pikturës.

Si u "takove" me pikturën?

Takimi i parë me pikturën ka qenë që në fëmijërinë e hershme në moshën 4-5 vjeçare. Më pas fillova kurse të posaçme piktore, që në moshën 6 vjeçare deri afër-



sisht kur isha 15 vjeç. Siç e kam thënë papritur erdhi dhe shkëputja ime 7-vjeçare nga piktura, e cila kur u rikthye lindi si një shpërthim i madh emocionesh dhe frymëzimi, i cili u përcoll nga duart në telajo. Që në atë moment jetoj me artin, me pikturën çdo çast timin dhe ndihem shumë mirë që kjo teknikë e

të bërit art është bërë pjesë e imja.

Simbolika e gjurmëve që të shtyhu në hapjen e ekspozitës? Pse pikërisht "Gjurmë"?

Gjurmë është një fjalë shqipërisht që ka shumë peshë si në shqiptim, por edhe në kuptimin që mbart. Për mua ka shumë rëndësi kuptimi i parë



i saj, po ashtu edhe ai metaforik. Fillimisht ajo simbolizon gjurmët e gishtërinjve në telajo si rrjedhojë të

teknikës që unë përdor. Po ashtu, gjurmë për gjurmët që ka lënë arti tek unë si artist gjatë kësaj periudhe. Ndry-

shimin e madh që kanë bërë këto gjurmë në jetën time, të cilën e kanë zbkuruar dhe vazhdojnë ta zbkurojnë ndaj unë sot mundohem që nëpërmjet kësaj ekspozite të ndikoj sadopak për mirë me anë të pikturave në jetën e gjithsecilit që i shikon.

Jeta mbi një telajo. Cilat janë ngjyrat mbizotëruese?

Ngjyrat për një artist janë instiktive. Ato lindin nga thellësia e shpirtit. Për mua ngjyrat që përdor një piktor flasin më shumë se çdo gjë tjetër. Unë personalisht i pëlqej ngjyrat e forta, plotë jetë. Më pëlqen ta shikoj botën me ngjyrat që unë përdor në telajo, të cilat mbushin zbrazëtinë që mund të ndiej kur shoh përreth. Një nga ngjyrat e preferuara kam të kuqen, madje është një e kuqe e veçantë për mua, e cila nuk është ndarë kurrë nga gishtërinjët e mi. Jeta në telajo duhet të jetë e gjallë, të shikoj përtej asaj që sheh syri të bëhet njësh me imagjinatën e artistit.

Vendi që nuk do zgjidhja kurrë për të pikturuar?

Vendi që nuk do zgjidhja kurrë për të pikturuar besoj se do ishte vendi, ku sërisht do zgjidhja pikturën për të shpëtuar prej tij. Nuk ka të bëjë vendi, por mënyra se si artisti e shikon çdo mjedis që ndodhet dhe e përcjell atë në telajo. Edhe në Mars po të shkoja do pikturoja. (qesh) Pra, nuk e kam menduar kurrë këtë pyetje. Artin për mua nuk ka as kohë e as vend të caktuar që mund ta ndal.

Përveç artit, cilat janë pasionet që të rrëmbejnë shpirtin?

Kam pasur pasione plot që në vegjëli. Kam qenë shumë i lidhur me sportin, po ashtu vazhdoj të jem edhe sot. Kam luajtur 10 vite basketboll ku kemi dalë kampion të Shqipërisë me ekipin. Basketbolli ka qenë një nga pasionet më të mëdha që kam pasur. Por, di të them që shpirtin ma ka rrëmbyer vetëm piktura që në momentin që u rikthye tek unë. Është ndjesi e pashpjegueshme me fjalë madje ka momente që humbas pas saj deri në pafundësi. Ndoshta, kjo është e bukura e forcës së artit.

Vendi më i përshtatshëm për të pushuar pas një dite "uragan"?


Më pëlqen shumë natyra. Kur e shikoj që jam i



Arian Çani thumbon keq Ronela Hajatin, reagimi i saj do ju habitë

Ronela Hajati është një ndër këngëtarët më të zënë në tregun shqiptar të muzikës, që shpesh është në qendër të mediave rozë. Dhe kështu ka ndodhur ditët e fundit pas një deklarate të moderatorit Arian Çani, i cili gjatë rubrikës 'Mix blind test', ka lënë pa fjalë publikun me reagimin dhe thumbimin që ka bërë për Ronelën.

"Hiqë fare këtë Cherr se s'na intereson kjo këngëtare është kot fare. As nuk e përmend fare cila është, më krijon një kështu ajo mua, nuk e dua jo. Hynë në atë kategorinë e këngëtareve që nuk i ashtu dot fare, më krijon një gjë negative shumë. Më mirë që se gjetët", ka thënë Çani duke shtrembëruar fytyrën. Pak me vonësë, por edhe Ronela ka reaguar më në fund me anë të një postimi në 'Instastory'. 'Pushoni në paqe gjepura' pa sqaruar asgjë më tepër në lidhje me thumbimin e saj që me siguri i drejtohet Çanit.



Elgiti ka "këputur mishin", Klea zbulon ç'ka ndodhur me këngëtarin

Ata janë ndër çiftet më të dashur për publikun. U desh pak kohë, gati një vit që Klea Huta dhe Elgiti Doda të konfirmimin se ishin të lidhur, ndërsa tani çifti kanë mbi dy vite në krahët e njëri-tjetrit. Ata janë shumë aktivë në rrjetet sociale, ku publikojnë shpesh foto bashkë dhe na duhet ta pranojmë që postimet e fotove apo video janë të denja për ato faqet e njohura të çifteve simpatikë. Mirëpo, fotoja e fundit duket se nuk ka shkuar ashtu siç e kanë planifikuar dhe me shumë humor, Klea e ka shpjeguar vetë arsyen. Teksa shfrytëzuan kohën e mirë në fundjavë, çifti ka tentuar të realizojnë një foto të bukur. Egiti është munduar ta ngrrejë në krahë bukuroshen, po nuk ia dolën tamam dhe Klea ia vë fajin disa kilogramëve të tepert duke u shprehur me shaka se Elgiti "këputi mish" për këtë foto.



ngarkuar gjej qetësi vetëm në natyrë. Preferoj në pjesën më të madhe të kohës ta sodis i vetëm, por gjithashtu edhe me shoqërinë time ose familjen, të cilët gjej rastin ti përshëndes pasi më kanë ndihmuar shumë në këtë rrugëtim. Çdo njeri për mua ka nevojë për natyrën pasi ajo e ndihmon të qetësohet, ta njoh veten më mirë dhe të qartësojë mendimet dhe vizionet që ka.

Dita e zakonshme e një

piktori?

Pyetje interesante. (qesh) Nuk dua ta përgjithësoj përgjigjen, sepse çdo artist ka rutinën e tij. Për mua zakonishtë është në studio, sidomos këtë periudhë që jam përgatitur për ekspozitën. Është një rutinë që të merr me vete madje ke nevojë për njerëzit e tjerë rreth teje të të nxjerrin sadopak për të dalë prej saj. Zgjohem çdo mëngjes duke menduar për pikturën. Punoj për realizimin e tyre.

Më pas fle duke menduar për to sërisht. Por kjo nuk do të thotë që s'kam jetë sociale edhe pse ndrydhet pak ngaqë ky lloj arti kërkon qetësi dhe vetmi. Mendohem t'i alternoj të dyja. Të dal për të gjetur frymëzim kur më mungon, të cilin e gjej si të njerëzit që takoj në përditshmëri, po ashtu edhe në vendet ku shkoj për të kaluar kohën e lirë, pse jo edhe për të pirë një gotë vere. Jam munduar mos të lë pas edhe aktivitetin fizik, i


cili të ndihmon shumë të jesh i kthjellët dhe të ndihesh më mirë. Dal zakonisht pasditeve për ecje te parku i liqenit, ku merret dhe oksigjeni i nevojshëm për trurin. gjithashtu, qetësoj shikimin kur e kam të lodhur.

Një kthim pas në kohë, çfarë do ndryshojë?

Në qoftë se do kthehesha pas në kohe nuk do ndryshoja asnjë gjë. Do thoni ju pse? Për mua çdo gjë që ka ndodhur në të kaluarën

time ka ndërtuar pikturin, artistin që jam sot. Edhe ngjarjet ose momentet e padëshirueshme kanë pasur ndikimin e tyre tek unë madje më të fuqishëm se ato të mirat. Nuk është e lehtë të krijosh. Por, që të krijosh duhet të prekësh të gjitha aspektet e jetës edhe kur ajo është kundra teje ti ta kthesh në forcë dhe të fitosh prej saj. Besoj se ky burim frymëzimi dhe idesh që kam sot në pikturat e mia janë të lidhura ngush-

të edhe me të kaluarën time. Gjithsecili duhet ta kthejë kokën pas, por jo të mos vazhdoj përpara. Të marrë mësim nga e kaluara, të jetoi të tashmen dhe të shoh të ardhmen. Këtë mendohej ta përcjell edhe në artin tim. Jam i lumtur për çdo gjë që më ka ofruar jeta dhe e falënderoj për talentin që më dhuroi, ndaj do përpiqem me gjithë zemër që të shpaloj me ju sepse për mua nuk ka gjë më të fuqishme se arti.



Kryeministri kosovar: S'ka vend për ata që flasin me urrejtje

"Bombardimet e NATO-s genocid ndaj Serbisë", Haradinaj shkarkon zv/ministren serbe

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka shkarkuar nga detyra zëvendësministren e Drejtësisë, Vesna Mikić, një ditë pasi ajo tha se bombardimet e NATO-s ishin genocid ndaj shtetit dhe popullit serb. Lajmin e ka bërë të ditur vetë kreu i qeverisë së Kosovës, i cili në një postim në rrjetet sociale tha se "në qeverinë dhe institucionet e Republikës së Kosovës, nuk kanë



RAMUSH HARADINAJ:

"Në qeverinë dhe institucionet e Republikës së Kosovës, nuk kanë vend individët, pavarësisht përkatësisë etnike, që denigrojnë vlerat e përbashkëta euro-atlantike. Deklarata e zëvendësministres në Ministrinë e Drejtësisë, Vesna Mikić, se bombardimet e NATO-s ishin genocid ndaj shtetit dhe popullit serb, janë të papranueshme dhe përkrijnë me gjuhën e urrejtjes, që sanksionohen me Kushtetutë dhe ligj", -tha kryeministri kosovar.

vend individët, pavarësisht përkatësisë etnike, që denigrojnë vlerat e përbashkëta euro-atlantike. Aq më tepër kur shteti i Kosovës është krijuar pikërisht në bazë të këtyre vlerave. Deklarata e zëvendësministres në Ministrinë e Drejtësisë, Vesna Mikić, se bombardimet e NATO-s ishin genocid ndaj shtetit dhe popullit serb, janë të papranueshme dhe përkrijnë me gjuhën e urrejtjes, që sanksionohen me Kushtetutë dhe ligj. Prandaj, sot kam liruar nga detyra zëvendësministren Mikić."

Times: Gjendet hard-disku i braktisur gjatë një konflikti zjarri

Humbet ndaj ushtrisë kurde, ISIS planifikon sulme në Europë

Zbulohen planet pas marrjes së qyteteve në Siri

Militantët të grupit terrorist Shteti Islamik po planifikojnë sulme në disa qytete të mëdha europiane, sipas një raporti të shërbimeve sekrete britanike. Dokumentet e zbuluara nga e përditshmja Sunday Times paralajmërojnë se terroristët po grumbullohen nën një "departament për operacionet në Europë", siç e quajnë vetë xhihadistët. Celulat e terrorit po organizohen nga vetë xhihadistët që jetojnë në vendet europiane, të cilët janë gati të presin edhe militantët që po largohen nga ish-territoret e Shtetit Islamik në Irak e Siri, të cilat tashmë janë çliruar pas sulmeve të fuqive të mëdha. Siç shkruan Sunday Times, planet u zbuluan në një hard disk që u ra në duar militantëve pro-perëndimorë gjatë një betejeje të një muaji më parë në Siri, pasi zbrapsën luftëtarët e Shtetit Islamik. Prej 2015-s, xhihadistët e Shtetit Islamik janë përgjegjës për disa sulme terroriste me qindra viktime nëpër Europë, Shtetet e Bashkuara, Australi e Rusi. Këtë muaj, xhihadistët humbën edhe fortesën e tyre të fundit, qytetin Baghuz në Siri, pranë kufirit me Irakun. "Sulmet kërkojnë të mbështesin qelizat tashmë të krijuara në Europë, ndërsa skuadrat e vdekjeve janë formuar në Siri për të goditur objektivat e veta", shkruan gazeta. "Këto të dhëna u zbuluan në një hard-disk të braktisur gjatë një konflikti zjarri midis elementëve dhe forcave lokale dhe ato të ISIS-it", thekson "Times". Luftëtarët kurde sirianë, aleatë të amerikanëve kanë fituar përfundimisht kundër ISIS-it, pasi morën bastionin e fundit të grupit militant në Sirinë Lindore, deklaroi para disa ditësh një zyrtar kurde. "Forcat Demokratike të Sirisë deklarojnë eliminimin total të të ashtuquajturit Kalifat dhe humbjen territoriale prej 100 për qind nga ana e ISIS-it. Në këtë ditë të veçantë, ne përkujtojmë mijëra martirë, përpjekjet e të cilëve bënë të mundur fitoren", tha Mustafa Bali, zëdhënës Forcave Demokra-



tike Siriane, të mbështetura nga SHBA. Bastioni i fundit i ISIS-it ishte Baguzi. I vendosur pranë lumin Euftrat, në Sirinë Lindore, e pasur me burime energjetike, pranë kufirit me Irakun, ai ishte territori i fundit i rëndësishëm që ishte ende në duar të ISIS-it. "Forcat Demokratike Siriane" dhe ushtria kurde të mbështetura nga SHBA, njoftuan se lirimim e bastionit Baghuz, zona e fundit e vendit që kishte mbetur nën kontrollin e ISIS. Mustafa Bali, zëdhënës i ushtrisë, shkroi në Twitter se "Baghuz është i lirë dhe ne kemi arritur fitoren ushtarake kundër Kalifatit". Para disa kohësh edhe presidenti i SHBA, Donald Trump, njoftoi humbjen përfundimtare të ISIS në Siri. Bali pastaj vuri në dukje se ISIS, e cila kishte arritur të zgjerohet në vitet e fundit për të pushtuar një pjesë të madhe të vendit dhe Irakut fqinj, tani është zhdukur plotësisht.

Hakmarrja e Izraelit, sulmohet godina e inteligjencës së Hamas

Pak pas sulmit me raketë në Tel Aviv, Izraeli njoftoi se ka goditur dhe shkatërruar një ndërtesë tregatëshe në Gaza, e cila dyshohej si 'selia e fshehtë' e inteligjencës së Hamasit. "Është një burim qendror i bashkangjitur së bashku me objektiva të tjerë që ushtria po godet gjithë Rripin", shpjegoi një zëdhënës ushtarak. Më herët personat që ndodheshin brenda u paralajmëruan për sulmin e afërt dhe ishin në gjendje të largoheshin nga ndërtesa. Ndërkohë pas sulmit në një ndërtesë në Tel Aviv, ushtria izraelite pretendonte se ai që e hodhi raketën ishte Hamas, organizuesi i armatosur i lirimit palestinez, nga një postacion i zonës së Rafah, në jug të Strucias.

SKOCI, KUNDËRVAJTJE NË MES TË AUTOSTRADËS

Ky është momenti kur shoferi i një makinë futet kundra vajtje në autostradë duke shkaktuar një aksident masiv, në të cilin u përfshinë disa automjete. Përfundimi ishte përplasja kokë më kokë me një automjet në korsinë e shpejtësisë. Shoferi pësoi dëmtime të shumta, ndërsa në aksident u përfshinë disa automjete të tjera. Ngjarja e rëndë ndodhi më datë 20 mars, pak pas orës 14:00 të drekës. Policia konfirmoi se nga ngjarja pati disa të lënduar, megjithatë pa rezik për jetën.



FOTOLAJM

Megjithatë, Forcat Demokratike të Sirisë do të vazhdojnë "të luftojnë kundër mbetjeve të grupeve ekstremiste derisa

të eliminohen plotësisht". Në këtë ditë të veçantë ne përkujtojmë mijëra martirë, përpjekjet e të cilëve kanë bërë të

mundur fitoren." u shpreh ai. Forcat pro-kurde kanë ngritur tashmë flamuj të verdhë në Baghuz për të festuar fitoren.

SHKURT

Vrau më 2015/ britaniku arrestohet në Romani

pas disa vitesh

Ai ishte një nga personat më të kërkuar në Britaninë e Madhe, për shkak të një vrasjeje të kryer në vitin 2015. Quket Shane O'Brien, 31 vjeç dhe iku nga Britania në momentin që ka vrarë Josh Hanson, 21 vjeç. O'Brien e goditi me thikë Hansonin, në perëndim të Londrës. Pas më shumë se 3 vjet kërkim, policia londineze e arrestoi të riun, shkruajnë mediat britanike. O'Brien akuzohet për vrasje dhe së shpejti do të nisin procedurat për ta ekstraduar atë. Ai ishte ndër personat më të kërkuar prej Interpolit në botë dhe çdokush që kishte informacion për të, paguhej 50 mijë paund. Nëna e viktimës tha në rrjetet sociale se falënderon policinë britanike që ka kapur më në fund vrasësin e dyshuar të të birit. Ajo u shpreh se kërkon drejtësi dhe kriminelin të marrë dënimin që meriton.

Stoltenberg: Gjeorgjia do të bëhet anëtare e NATO-s

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, gjatë një vizite në Gjeorgji është shprehur i bindur se ky shtet do të anëtarësohet në NATO, pavarësisht kundërshtimit të ashpër nga Kremli. I pranishëm në Tbilisi, Stoltenberg zhvilloi takime me zyrtarët gjeorgjiano për të parë nga afër ushtrimet ushtarake me forcave të NATO-s dhe ushtrisë gjeorgjiane. Pranë kryeministrit gjeorgjiano, Mamuka Bkhtadze, Stoltenberg u shpreh i bindur që Gjeorgjia do të bëhet anëtare e NATO-s. "Ne do të vazhdojmë të punojnë së bashku për ta përgatitur anëtarësimin e Gjeorgjisë. Nuk pranojmë që Rusia apo ndonjë fuqi tjetër të vendosë së çfarë mund të bëjnë shtetet anëtare", tha ai. Në anën tjetër, Bkhtadze u shpreh se anëtarësimi në NATO është zgjedhje dhe popullit të Gjeorgjisë. Gjatë samitit të NATO-s në vitin 2008, NATO ishte pajtuar që Gjeorgjia të bëhet anëtare në këtë aleancë, por ende nuk është caktuar ndonjë datë për anëtarësimin, ndonëse perspektiva e këtij shteti është konfirmuar në çdo samit.

Masakra serbe, si u vranë 193 shqiptarë të pafajshëm në Kosovë

E dhe pse kanë kaluar vite nga përfundimi i luftës në Kosovë, banorët e shumë zonave përkujtojnë të rënë në luftë nga regjimi spastrues i Sllobodan Milloseviç apo njohur ndryshe si "Kasapi i Ballkanit". Nga dora e kriminele serbe u vranë 20 vite më parë u vranë 75 civilë në Celinë, 69 në Fortesë, 49 në Brestoc të Rahovecit, ndërsa ranë heroikisht edhe pesë dëshmorë. Masakrat u kryen një ditë pas fillimit të bombardimeve ajrore nga forcat e NATO-s kundër forcave kriminale serbe në Kosovë.

BOTIMET

Gazeta e Mid'hat Frashërit më 1908: Kemi qenë të egër, erdh dit' e lirisë

Fatmira Nikolli

O vëllezër! Dërgoni te dem se unë dy fjalë sqip: sot na erdhi ajo dit' e lirisë q'e prisnim qe kage koh'e tehu, sot na erdhi ajo dit' e bukure, sot u hap erësira se na erdh drita, sot lindi djell i bukur i lirisë.

Per me sot kemi rojturë ne t'epet, kemi qenë të çarë, të përndarë, t'egër! Sot na erdh kopha që të zëmë bashkimin, vëllazërinë, dashruinë, tyë zëmë të bëhemi të urtë dhe të përparojmë n'udhë të qytetërisë dhe të trashëgojmë jetënë. Sot zëmë të rojmë, se sot për herënb e parë n'istori nxjerrim zënë të presim përpara një shumicë të tillë: Qoftë Lirija! Qoftë bashkim! Qoftë Dashuria!


Me këtë frazë mbyllet një nga artikujt e gazetës "Lirija" që e botoi Mid'hat Frashëri në vitet 1908-1910.

Dy botime të reja do të jenë së shpejti në duart e lexuesve dhe studiuesve të Lumo Skëndos. Një njoftim i Bibliotekës Kombëtare, shpërndarë dje mediave, thotë se bëhet fjalë për gazetën e 1908-ës "Lirija" dhe për aktet e konferencës së mbajtur vitin e kaluar për themelimin e revistës "Diturija".

Botimet vijjnë si bashkëpunim mes Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë dhe Fondacionit Arsimor Kulturor Humanitar - ALSAR. Puna mes tyre zuri fill me përgatitjen dhe botimin anastatik të revistës "Diturija" të Lumo Skëndos, pikërisht në vitin e kthimit të eshrave të tij në atdhe dhe në kuadër të kremtimeve të 110-vjetori të Kongresit të Manastirit, kryetar i të cilit Mid'hat Frashëri u zgjodh njëzëri.

GAZETA "LIRIJA" (1908-1910)

Duke çmuar dhe vlerësuar veprën e gjerë kulturore, shkencore e atdhetare të Mid'hat Frashërit, BKSH dhe ALSAR, gjykuan të vlefshme të pasuronin bibliotekat e sotme me një botim të ri anastatik. Bëhet fjalë për botimin e gazetës që ai themeloi më 1908 dhe e botoi deri në vitin 1910, me titullin simbolik "Lirija". Ndonëse një pjesë e mirë e artikujve të kësaj gazete janë ribotuar në botimet e sotme bashkëkohore të veprës së tij, shfletimi i gazetës "Lirija" në tërësinë e saj do të lejojë një studim më të thelluar të veprimtarisë publicistike e politike të Lumo Skëndos si dhe kuptim e analizë më të mirë të kontekstit politik e kulturor në të cilin ajo u botua. Njoftimi i BKSH-së thotë se qysh më parë ishte vënë re fakti se koleksionet e kësaj gazete të hershme, kishin mangësi në plotërinë e tyre në disa biblioteka të vendit, si dhe dëmtime të konsiderueshme në shumë numra. Për këtë arsye, specialistët e Bibliotekës Kombëtare, mbasi përgatitën koleksionin e plotë, falë edhe bash-



këpunimit me Bibliotekën publike të Elbasanit, i hapën udhë kësaj marrëveshjeje të re me Fondacionin ALSAR, që u lidh në "Sallën Lumo Skëndo" të BKSH-së jo rastësisht më 25 mars, pikërisht në ditën e lindjes së Mid'hat Frashërit, si një shenjë nderimi për të e veprën e tij, veprë që vijon të na falë bujarisht dije, kulturë e krenari të ligjshme. Së shpejti, ky botim anastatik, do të plotësojë bibliotekat e vendit si dhe ato të studiuesve e lexuesve gjithnjë e më të shumtë.

THEMELIMI I REVISTËS "DITURIJA"

Konferenca shkencore "Lumo Skëndo dhe themelimi i revistës Diturija" synoi të hedhë dritë mbi vlerat ende të paçmuara apo të panjohura të Diturisë dhe të autorit të saj. Ajo u zhvillua në dy edicione të



Botimi anastatik që plotëson mangësitë e koleksioneve



suksesshme, në Tiranë më 10 tetor dhe në Prishtinë më 6 nëntor, 2018. Bashkëpunimi e përkushtimi i studiuesve të mirënjohur në shqyrtimin dhe paraqitjen e vlerave unike të revistës Diturija dhe të personalitetit polidrik të Lumo Skëndos i solli konferencës pasurinë e perspektivave të larmishme, prej të cilave figura e Lumo Skëndos u shfaq në plotërinë e saj përmes leximesh kulturologjike, historike, gjuhësore, imagologjike etj., duke rikthyer në bashkëkohësinë tonë profilin e një intelektualit të shkëlqyer të botës shqiptare.

Paralelisht me këtë, specialistët e Bibliotekës Kombëtare ndërmorën edhe hartimin e "Bibliografisë së re-

visitës Diturija", një kontribut i çmuar shkencor përmes të cilit vjen një ndihmesë e vlefshme për kërkuesit në thellimin e njohjes së kësaj veprë monumentale të kulturës shqiptare. Falë vijimit të bashkëpunimit me Fondacionin "Alsar", kjo bibliografi do të botohet së bashku me aktet e konferencës si vijim i dy vëllimeve të hijshme të "Diturisë".

Gjatë ceremonisë së zhvilluar me këtë rast në sallën "Lumo Skëndo" të Bibliotekës Kombëtare ditën e hënë, 25 mars, drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare, Prof. Dr. Persida Asllani, u shpreh se "nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi vjen pikërisht në ditën e lindjes së Mid'hat Frashërit, si një shenjë nderimi për të e veprën e tij. Koleksionet e kësaj gazete të hershme kishin mangësi në plotërinë e tyre në disa biblioteka të vendit, si dhe dëmtime të konsiderueshme në shumë numra. Ky botim anastatik do të plotësojë bibliotekat e vendit si dhe ato të studiuesve e lexuesve gjithnjë e më të shumtë".

Në fjalën e tij përshëndetëse drejtori i Fondacionit ALSAR, Mehdi Gurra, u shpreh se "përkujtimi i figurave kombëtare dhe i veprave të tyre është tejet i rëndësishëm për të ardhmen dhe brezat që vijnë më pas. Bashkëpunimi i nisur me Bibliotekën Kombëtare, së pari, me botimin anastatik të revistës "Diturija", do të vijojë më tej edhe me punë të tjera shkencore. Është shumë vyer të botojmë sa më shumë vepra shkencore të periudhës së Rilindjes shqiptare, si një etapë e rëndësishme e shtetformimit dhe kombi shqiptar, të cilat do të dokumentojnë dhe risjellin në vëmendje këtë periudhë historike".

"AS TË PARËT, AS TË FUNDIT"
NJË RRËFIM NGA NJË PSIKOLOGE



rrjedhshëm nëntë gjuhë të huaja, drejton një klinikë psikoterap-

Deri tani, monogamia ka qenë konfigurimi ynë standard dhe bazohet në supozimin që, kur dashuron vërtet, nuk tundohesh më nga të tjerët. Kjo është arsyeja pse shpesh një flirt apo tradhti shërben për të nisur bisedën. Pasi trilli merr fund dhe nuk vazhdon të mbrohet më, mund të filloni të jeni më të hapur me njëri-tjetrin. Një lexim i detyruar për të gjithë ata të cilët kanë tradhtuar, janë tradhtuar apo thjesht kanë nevojë për një strukturë të re mendore dhe emocionale me të cilën të kuptojnë lidhjet. I tillë konsiderohet libri i Esther Perel "As të parët, as të fundit", botim i Pegit përkthyer nga Artan Miraka. "Pavarësisht se sa bojë është derdhur për të na këshilluar se si ta "mbrojmë nga tradhtia" marrëdhënien tonë, kjo nuk i ka mbajtur në fre as burrat dhe

as gratë. Mosbesnikëria ndodh në martesat e mira, në martesat e këqija, e madje edhe atje ku dënohet me vdekje. Ajo ndodh edhe në marrëdhëniet e hapura, ku seksi jashtëmartesor është negociuar me kujdes që më parë. Dhe lirija për t'u ndarë apo divorcuar nuk i ka nxjerrë ende nga moda gënjeshtër. Pasi i kam hyrë thellë e më thellë kësaj teme, kam dalë në përfundimin që nuk ka asnjë të vërtetë të thjeshtë dhe asnjë tipologji gjithëpërfshirëse, që ta përshkruajë këtë sprovë të pasionit dhe të tradhtisë. E vetmja gjë, që mund ta them me siguri, është se asgjë nga ato që do t'ju tregoj nuk është e stisur", thotë autorja.

Esther Perel, psikologe dhe autore e librave të shumëshitur, njihet sot si zë më ndikim në fushën e marrëdhënieve dhe të lidhjeve moderne. Perel-i flet

peutike në Nju-Jork dhe punon si këshilltare e jashtme për disa nga shoqëritë më të mëdhanë botë. Fjalimet e saj në TED kanë pasur mbi 20 milionë shikime. Libri i saj i parë, *Mating in Captivity: Unlocking Erotic Intelligence*, u kthye në fenomen dhe u përkthye në 24 gjuhë të botës.

Perel është botuar në The New York Times, The Washington Post, The *Wall Street Journal*, Le Monde, The Guardian, The New Yorker dhe Vogue. Ajo është e ftuar e përhershme në shfaqje radiofonike dhe televizive, përfshi Brian Lehrer Show të NPR, Oprah, The Today Show, Dr. Oz dhe The Colbert Report. Përveç praktikës terapike të saj 30-vjeçare në Nju-Jork, Perel është një mësuese dhe spikere shumë e njohur në të gjithë botën.

Opinion i Ditës

Shoumeni i madh i Europës

Nga Alexander Clarkson

(vijon nga faqja 1)

... ka një aftësi të spikatur për të diktuar axhendën e lajmeve në Europë. Përmes shfaqjeve të tij butaforike, ai ka ndërtuar një markë që u bë menjëherë e njohur, shënoi një ngjitje marramendëse në pushtet, dhe ka ruajtur që atëherë vëmendjen e kontinentit.

Kur hasi në vështirësi, si më së fundi kur u sulmua nga lëvizja anti-establishment e Jelekëve të Verdhë, Makron përdori fasadat, si takimet qytetare apo traktatin franko-gjerman të Ahenit me kancelaren Angela Merkel, për të rifituar popullaritetin e humbur.

Letra e hapur e kësaj jave, që u botua nga gazetaret në ç'do vend të BE-së, nuk përbën ndonjë përgjithim. Të fokusohesh në përmbajtjen e saj dhe propozimet e politikave, do të thotë të humbasësh thelbin e këtij akti. Qëllimi i tij i vërtetë, qëndron në atë që na tregon, drejtimin e politikës në një kontinent në ndryshim të shpejtë.

Letra e Makron, është një thirrje për një BE më aktive dhe më të fuqishme. Ajo i drejtohet kryesisht një audience të brendshme. Presidenti francez, po kërkon të tërheqë mbështetjen e votuesve të cilët, megjithëse janë në përgjithësi në favor të BE-së, do të ishin më të prirur për të votuar për socialistët, të gjelbërit apo Republikanët e qendrës së djathtë në Francë.

Me partinë e tij "La République En Marche" me vetëm paksa mbi 20 për qind në sondazhe, kokë më kokë me udhëheqësen e ekstremit të djathtë të Tubimit Kombëtar, Marin Lé Pen, Makron nuk ka luksin të humbasë ndonjë mbështetje nga e djathta ose nga e majta.



Por, letra kishte, gjithashtu, edhe një audiencë tjetër: Polemikant e menjëhershme që shkaktuan propozimet e tij në të gjithë

Europën, i dhanë Makron një mundësi tjetër, për të shitur veten si udhëheqësi i vetëm i aftë që mbron projektin evropian nga një

sulm i populistëve.

Shkalla në të cilën Makron vuri prestigjin e tij personal, në frontin e betejës elektorale për Parlamentin Europian, dhe jehona e mesazhit të tij në mbarë Europën, flet, gjithashtu, për vetëdijen e tij, se faza politike evropiane është vendimtare për udhëheqësit kombëtarë.

Një apo dy dekada më parë, krerët e shteteve do t'i kishin trajtuar zgjedhjet e Parlamentit Europian, thjesht si hapin e radhës. Tani, përqendrimi gjithnjë e më i dukshëm i fuqisë kolektive në duart e institucioneve të BE-së, i ka

bërë ato mjete me vlerë, ku ia vlen të shpenzohet një kapital i madh politik për të fituar.

Gjithkush është duke u angazhuar për të diktuar të ardhmen e BE-së. Nuk është një fushëbetejë e lehtë, ku mund të kesh epërsi. Krizat e njëpasnjëshme, eurozona, emigrimi, Brexit, krijuan domosdoshmërinë e një debati politik ndërkuftar. Por, pasojat e tyre i kanë polarizuar shoqëritë, dhe kanë forcuar politiken e partive kombëtare.

Reziqet e mëdha në këto zgjedhje për të ardhmen e BE, kanë mpërhur linjat e betejës ideologjike, midis rrjeteve rivale partiake brenda Parlamentit Europian, dhe midis forcave politike në nivel kombëtar. Kjo ka bërë që të jetë më e vështirë gjendja e konsensusit evropian.

Gjithkush, pro-evropianët dhe euroskeptikët, po përipiqen të dominojnë në debatin politik, dhe të vendosin mbi të ardhmen e BE-së. Dhe mjeti më i mirë për ta bërë këtë, janë shfaqjet e shkëlqyera publike, që shfrytëzojnë çështjet evropiane në avantazhin e tyre.

Kështu është gjenerata e re e liderëve të BE-së, duke përfshirë Makronin, dhe në anën tjetër udhëheqësin e të djathtës italiane, Mateo Salvini, si dhe të tjerë, janë duke luajtur se kush do të kontrollojë BE-në. Këto ditë, sukcesi kombëtar është i lidhur me aftësinë për të shkëlqyer në skenën evropiane. Zhgënjimi kryesor nga letra e Makron, është se shoumeni më i madh i Europës, e ka kuptuar më mirë se kushdo tjetër, "manualin" e ri të lojërave.

Shënim: Alexander Clarkson, është lektor mbi studimet evropiane në Kolegjin Mbretëror në Londër

Gjithkush, pro-evropianët dhe euroskeptikët, po përipiqen të dominojnë në debatin politik, dhe të vendosin mbi të ardhmen e BE-së.

Dhe mjeti më i mirë për ta bërë këtë, janë shfaqjet e shkëlqyera publike, që shfrytëzojnë çështjet evropiane në avantazhin e tyre



Opinioni / Ditës

Të mos zgjedhësh të keqen më të vogël

Nga Slavoj Zizek

(vijon nga faqja 1)

... 1920, gjeorgjiani u pyet nga një gazetar se cili devijim ishte më i keq - i djathti (i Buharinimit me shoqëri), apo i majti (Trocki me bashkëpunëtorë)?

Përgjigja e tij ishte: "Të dyja janë më të këqija".

Vërtet, është shenjë pikëlluese e telasheve tona që, kur ballafaqohemi me një zgjedhje politike dhe duhet të pozicionohemi për një anë, edhe nëse ajo është më pak e keqe, shumë shpesh përgjigja që imponohet është: "Por, të dyja janë të këqija".

Natyrisht, kjo nuk do të thotë se të dyja polet e alternativave janë të njëjta. Në situatat konkrete, ne duhet që, për shembull, kushtimisht t'i përkrahim protestat e 'Jelekverdheve' në Francë, ose ta bëjmë një pakt taktik me liberalët për bllokimin e kërcënimeve fundamentaliste ndaj lirisve tona (kur fundamentalistët dëshirojnë t'i kufizojnë të drejtat për abort, ose të ndjekin haptas politika raciste).

Sidoqoftë, kjo do të thotë që shumica e zgjedhjeve tona të cilat na imponohen nga mediati e mëdha janë zgjedhje të gënjeshtërtë - funksioni i tyre është që ta mjeçulllojnë opsionin e vërtetë.

Është një leksion i trishtueshëm që duhet ta marrim prej kësaj: nëse njëra palë e konfliktit është e keqe, pala tjetër nuk është domosdoshmërisht e mirë.

PËRZGJEDHJET E ZYMTA

Ta marrim në konsideratë situatën e sotme në Venezuelë: e duam Maduron apo Guaidon? Të dyja janë më të këqija, ndonëse jo në kuptim të njëjtë. Maduro është "më i keq", sepse sundimi i tij e sollti Venezuelën në fiasko të plotë ekonomike, derisa shumica e popullit jeton në varfëri të mjerueshme, situatë e cila nuk mund t'i atribuohet vetëm sabotimit nga armiqët e brendshëm dhe të jashtëm.

Mjafton ta kujtojmë demin e pashlyeshëm të cilin regjimi i Maduros ia ka bërë idesë së socializmit: për dekada me radhë do të detyrohemi t'i dëgjojmë variacionet e llojit: "Doni socializëm? Shikoje-ni Venezuelën".

Sidoqoftë, Guaido nuk është më pak "më i keq" në kohën kur e filloi presidencën e supozuar, pa dyshim se u bëmë dëshmitarë të një puçi të orkestruar mirë nga Amerika, e jo të një kryengritjeje autonome popullore (që është saktësisht koncepti "më i mirë" që iu mungon alternativave të Maduros dhe Guaidos të cilat janë "më të këqija").

Ne nuk duhet t'i shmangemi aplikimit të së njëjtës logjikë edhe ndaj luftës mes populistëve dhe liberalëve të establishmentit, gjë që i



karakterizon demokracitë perëndimore aktualisht. Sa i përket politikës amerikane, kjo do të thotë se përgjigja në pyetjen: "Kush është më i keq, Trump apo Clinton (ose tash Pelosi)?" duhet të jetë: "Të dy janë më të këqijtë!".

Trump është, natyrisht, "më i keqi": agjent i "socializmit për të pasurit", rrënues sistematik i normave të jetës së civilizuar politike, çmontues i të drejtave të pakicave dhe injorues i kërcënimeve ndaj ambientit tonë, mes tjerash.

Mirëpo, në një kuptim tjetër, establishmenti demokratik, gjithashtu, është "më i keqi": asnjëherë s'është të harrojmë se ishte dëshimi i brendshëm i establishmentit demokratik ai i cili krijoi hapësirë për populizmin e Trumpit. Kështu, hapi i parë në mposhtjen e Trumpit është kritika radikale e elitave të ngurtësuar. Pse Trump dhe populistët tjerë mund t'i shfrytëzojnë frikërat dhe ankesat e njerëzve të rëndomtë? Sepse njerëzit ndihen të tradhtuar nga pushtetarët.

Çfarë do të thotë kjo, konkretisht? Mes tjerash, do të thotë se, ndonëse mund të tingëllojë e neveritshme, e majta nuk duhet të ketë frikë që të mësojë edhe nga Trump.

Aftësia për mashtërme Si operon Trump? Shumë analistë mendjehollë kanë theksuar se ndonëse ai nuk i cenon ligjet ose

rregullat e qarta (shumicën e tyre), e shfrytëzon deri në skajshmëri faktin se të gjitha këto ligje dhe rregulla mbështeten në sub-stancën e rregullave dhe zakoneve të pashkruara që na tregojnë si t'i aplikojmë ligjet dhe rregullat e qarta - ndërsa ai brutalisht i shpërfillo këto rregulla të pashkruara.

Shembulli i fundit (dhe, deri tash, më ekstremi) i kësaj procedure është shpallja e emergjencës kombëtare nga Trump. Kritikët e tij u shokuan për mënyrën në të cilën ai e aplikoi këtë masë, qartësisht të parashikuar vetëm për katastrofa të mëdha siç janë kërcënimet e luftërave ose fatkeqësive natyrore, me qëllim të ndërimit të murit si kufi për mbrojtjen e territorit të Amerikës nga kërcënimi i imagjinuar.

Sidoqoftë, jo vetëm demokratët ishin kritikë ndaj kësaj mase - disa djathtistë, gjithashtu, u alarmuan nga fakti se shpallja që bëri Trump vendos precedent të rrezikshëm: çfarë nëse një president i ardhshëm i majtë i demokrateve do ta shpallë emergjencë kombëtare ngrohen globale?

Argumenti im është se një president majtist do të duhej ta bënte pikërisht këtë, veçanërisht për faktin se ngrohja globale efektivisht është emergjencë kombëtare - dhe jo vetëm. E shpallur apo jo, ne tashmë JEMI në një gjendje emergjente.

Dhe kjo na kthen në bllokadën

aktuale me Brexit. Bllokada dobësuese e vendimmarrjes politike në Mbretërinë e Bashkuar dhe ndarja që kalon përmes dy partive tradicionalisht dominuese qartë demonstroi se të dyja palët janë më të këqijtë. Asnjëra nga to nuk duket të ketë vizion koherent politik, mirëpo të dyja e përziejnë oportunitizmin me shtrembërimet ideologjike.

Brexitasit janë "më të këqij" për shkak të bërtamës së tyre populiste-nacionaliste të të rezonuarit, anti-Brexitasit janë "më të këqij", sepse ata nuk e adresojnë vërtet atë që është thellësisht gabim në mënyrën në të cilën funksion tash BE-ja.

Zgjedhja e cila iu ofrohet britanikëve në instancë të fundit vetëm e riprodhon konfliktin global mes establishmentit liberal dhe reagimeve populiste ndaj tij.

Të dyja palët kanë dështuar ta adresojnë detyrën e vërtetë: si ta ndërtojnë një Europë të re e cila do ta rifitonte atë për të cilën ia vlen të luftohet në trashëgiminë emancipuese europiane. Në vend të kësaj, palët po e tradhtojnë këtë trashëgimi - njëra duke e shtyrë Europën mbraja në politikat shtet-kombëtare, tjetra duke e transformuar Europën në domen të ekspertëve teknokratë. Këto janë të dyja anë të katastrofës së njëjtë.

Marrë nga Klan Kosova

HOROSKOPI

DASHI

Është e nevojshme të vini re gjatë marrëdhëniet aktuale. Në fakt, gjatë kësaj të marte do të ndiheni të lodhur. Nëse do të kontrolloni disa dokumente të vjetra, mund të gjeni diçka të rëndësishme. Nuk rekomandohet t'i besoni një kolegut tuaj një plan me shumë vlerë për ju.

DEMI

Është dita e duhur për të menduar seriozisht për të ardhmen. Nëse nuk i keni përcaktuar saktësisht qëllimet tuaja, duhet ta bëni këtë marrëdhënieve personale, duhet të mendoni një plan strikt. Tregohuni të sinqertë me veten dhe me atë që dashuron.

BINJAKET

Disa Binjakë do të marrin një vendim të rëndësishëm sot. Kjo do të jetë një përpjekje për të zgjidhur problemet personale dhe financiare. Megjithatë, teksa përpiqeni të bëni më të mirën, mos i shkelni normat shoqërore.

GAFORJA

Mos hezitoni të ndërmerrni vendime për jetën tuaj personale dhe profesionale. Duke marrë këto vendime, mund të keni përfitime të mëdha. Në fund të ditës ka gjasa të zhvillonin një bisedë për të përcaktuar të ardhmen.

LUANI

Kjo ditë do të karakterizohet nga çështje dhe detyra urgjente. Bëni gjithçka që mundeni për ruajtjen e qetësisë. Komunikoni më shpesh me njerëz optimistë. Në mbrëmje, duhet t'i kushtoni vëmendje shëndetit tuaj.

VIRGJERESHA

Mos rritni në marrjen e vendimeve të rëndësishme. Bëni mirë të kërkoni një pushtim të shkurtër për të reflektuar thellësisht në përcaktimet e vendimeve tuaja. Shmangjeni entuziazmin e tepër për dëshuri ose miqësi, sepse mund të përballeni me skepticizmin ose talljen.

PESHORJA

Këtë ditë do të përqendroheni kryesisht në vepra paqësore dhe pozitive. Kjo ditë premon të jetë e qetë. Duhet t'i kushtoni vëmendje të veçantë çështjeve profesionale, planifikimit financiar dhe blerjeve të vogla. Ata që janë të vetëm duhet të analizojnë rrethin e miqve të vjetër.

AKREPI

Sot do të jeni të pakënaqur me veten. Me shumë gjasë nuk do arrini të përfundoni me kohë një projekt të rëndësishëm ose të arrini një marrëveshje me një partner biznesi. Përmbahuni nga bisedat konfidenciale dhe mos bëni deklaratat dashurie.

SHIGJETARI

Sot bëni mirë të merreni me punët e familjes për të sheshtuar konfliktet dhe mosmarrëveshjet. Shmangni udhëtime dhe lodhshmëri, pasi do të përballeni me një ezaurim nervor. Në mbrëmje, problemet mund të zhduken si një mjegull, pa lënë asnjë gjurmë.

BRICJAPI

Këtë të martë do të shpërqendroheni nga stresi i punës. Për pasojë nuk do jeni në gjendje t'i kushtoni vëmendje jetës personale. Në mbrëmje bëni mirë të shmangni çdo informacion që lidhet me punën dhe të argëtoheni me të dashurit tuaj.

UJORI

Do përballeni me një presion të tepër në të gjitha drejtë. Qetësia është taktika e duhur për të tejkaluar vështirësitë. Hartoni një plan rigoroz për çdo gjë, dhe kështu do të arrini të keni sukses.

PESHQIT

Do të jeni të pakënaqur me mirëqenien tuaj. Lodhja dhe jeta e vështirë do të jenë beteja juaj. Mjeti me i mirë është pushimi ose joga. Nëse nuk mund t'i realizoni këto, përpiquni t'i shmangni punët e tepërta.

SHPËRTHEN MESFUSHORI

Mesfushori i Kombëtares, Migjen Basha, për "Supersport" deklaroi pas ndeshjes se nuk e kishte pritur këtë qëndrim të Panuçit, duke e cilësuar thënien e tij si mungesë respekti. "Arsyeja e fitores është me vlerë, sepse na duheshin 3 pikë. E dimë që mënyra nuk ishte aq e mirë. E folëm me Bulkun para ndeshjes se na duhen

Basha: Panuçi tregoi që nuk ka respekt për ne

pikët. Nuk është e lehtë, edhe fusha me barë artificial, nuk na ndihmoi. I kemi të rëndësishme për të ardhmen këto 3 pikë. Ndaj Turqisë nuk e merituar atë humbje, por do vazhdojmë rrugën. Panuçi a mori një përgjigje? Këta janë lojtarët, por nuk e

ka kuptuar çfarë mendimi ka pasur ai. Negative apo pozitive. Mua më duket negative, dhe pa respekt për lojtarët që janë këtu. Ka disa lojtarë që kemi bërë historinë këtu, por për sa kohë jemi këtu, do mundohemi të ndihmojmë".

KAPITENI

Kapiteni i Shqipërisë, Elseid Hysaj u shpreh për 'RTSH Sport' se skuadra mori një fitore të madhe dhe të vështirë, duke pranuar se ishte një lojë e ashpër. Ai ka folur edhe për trajnerin e ardhshëm, duke shprehur në një italian. "Lojë e rëndë pasi ata na binin këmbëve. Kishim durim dhe nuk morëm kartonë duke luajtur fu-

Hysaj: Shpresoj të vijë një trajner italian

tbollin tonë. Fitore e rëndësishme për moralin dhe shqiptarët. Duhet të fitonim për të qenë në garë dhe shkojmë në shtëpi me buzëqeshje. Besimin do e kemi gjithmonë pasi janë dy ndeshjet e para. Kishim nevojë për moral dhe pas

kritikave nuk ishte e drejtë. Lider? Trajnerin e zgjedh presidenti, por për çunat duhet trajner që të na kuptojë mirë. Shpresoj të vijë një trajner italian pasi e njohin futbollin dhe të na japë dorë të mirë", tha Hysaj.

E para e dyshes Bulku-Mema nis me fitore. Kuqezinjtë nuk shkëlqejnë, por sigurojnë fitoren e parë



Jeton Selimi

Shqipëria largon hijet, fiton pastër 3-0 në Andorrë

Golashënues: Sadiku 21', Balaj 87' dhe Abrashi 95'

Turqia dhe epoka Panuçi është lënë pas. Një humbje e shëmtuar në sfidën e parë të vlefshme për Euro2020, që zh bëhet nga një fitore 3-0 në Andorrë. Natyrisht që vendi i vogël iberik do të jetë trepikësh i sigurt për të gjitha skuadrat që pretendojnë një vend në evropian, por duke parë klimën e rënduar në Kombëtaren kuqezi, fitorja ishte ajo që duhej, ndonëse loja nuk ishte e shkëlqyer, pavarësisht dominimit territorial.

Që Shqipëria kishte ardhur për fitore, kjo u kuptua që në këmbimet e para të topit. Uzuni është i papërmajtshëm kur në sekondën e 24-ët godet traversën dhe pak çaste më pas rrëzohet në zonë, por çuditërisht gjyqtari slloven Glova nuk akordon 11-metërsh. Kuqezinjtë këmbëngulin, por vujanë rrjedhshmërinë pasi padurimi për të shënuar bën të tijën. Gjithsesi për ta çuar Shqipërinë te goli do të mendojnë vetë lojtarët e Andorrës, me portierin Gomes që del keq nga zona dhe nuk arrin të largojë



topin, duke e lënë për Sadikun, i cili me portën e boshatisur nuk do ta ketë të lehtë të shënojë.

Pavarësisht disa zbritjeve të tjera, Shqipëria nuk do të shënojë më në këtë pjesë loje, ndër-

sa në të dytën loja do të ashpërohet dhe Andorra do të kërkojë të ngacmojë. Trajnerët Bulku e Mema do të nisnin ndërrimet për të freskuar skuadrën dhe, pasi disa shumë e shumë aksionesh të shpërdoruara,

i sapofuturi në fushë, Bekim Balaj, do të vendosë qetësinë te tifozët kuqezi të pranishëm në "Estadi Nacional" me golin e minutës së 87-të. Balaj përfiton nga një gabim në pasi i mbrojtësve të Andorrës,

GRUPI H

Nga rivalet e Shqipërisë, Franca fitoi pastër me shifrat 4-0, në shtëpi ndaj Islandës, ku golat i shënuan Umtiti, Zhiru dhe Mbape, ndërsa me pikë të plota gjendet edhe Turqia, që po ashtu fitoi 4-0 ndaj Moldavisë, me gola të Kaldirim, Aihan, dhe dopietës së Tosun.

EURO2020

GRUPI H		
TE HENEN		
Turqi - Moldavi		4-0
Francë - Islandë		4-0
Andorrë - Shqipëri		0-3
RENDITJA		
Skuadra	N	P
Franca	2	6
Turqia	2	6
Shqipëria	2	3
Islanda	2	3
Andorra	2	0
Moldavia	2	0

zonë pas gjuajtjes së fortë të Sadikut nga goditja e dënimit dhe me kokë shtyn topin në rrjetë, duke bërë që kuqezinjtë të kthehen të buzëqeshur me një fitore 3-0, e cila i lejon të ngjiten në vendin e tretë në grup në kuotën e 3 pikëve, njëjtë sa Islanda, por me golavarazh më të mirë sesa ishullorët.

SUKSESI I PARË

Trajneri i Kombëtares ditën e djeshme në ndeshjen ndaj Andorrës, Ervin Bulku, pas fitores 0-3 deklaroi për mikrofonin e "Supersport" se ishte i kënaqur me suksesin, ndërsa mbrojti edhe Kristian Panuçin, duke thënë se edhe italianin do të bënte zgjedhjet që bëri ai.

Çfarë ndryshoi ekipi sot (dje)?
Nuk kishte ndryshuar ndonjë gjë. Çunat treguan vlerat me rezultatin 0-3. Çdo rezultat tjetër, do ishte jo i përshtatshëm. Dhanë maksimumin. Treguan kualitetet. Jemi

Bulku: Panuçi do të bënte të njëjtat zgjedhje si unë

të bashkuar.
Ishim pak në presion në fillim, por e administruam duke shënuar...

Me zgjedhjet që bëra, duhej të fusnim lojtarë që luajnë mirë me topin, luajnë shpejt, sepse duhej ta ndërrojmë sa më shpejt krahn, të gjenim hapësirat. Duhet ta bënim më shpejt golin e dytë, jo të zgjasur aq shumë. Mundësitë i kishim.

Që kur Panuçi u largua, ke pasur komunikim se si do luajë Shqipëria?

Unë kam qenë njeri më i afërt, nuk duhet t'i hedhim poshtë kaq shpejt. Kemi menduar më shumë për ndeshjen me Turqinë, por diskutuam pak për Andorrën. Edhe ai po të ishte në vendin tim, do bënte ndoshta këto zgjedhje. Ky rezultat na kënaq.

Pret mesazh nga Panuçi?
Kur të shkoj në hotel do shoh telefonin.

Ishte fitore morale ndaj vetvetes më shumë se 3 pikë?
Kjo fitore duhej marrë me çdo kusht, me çdo mënyrë. E

thashë që rezultat i vetëm është fitorja. Pa diskutim, edhe pikët janë të rëndësishme, por edhe morali, sepse kishim bërë edhe ndeshje të mira, por pa rezultate. Andorra ishte e dobët, por ka barazuar në fushën e vet.

Kemi gabuar jo rralë me ekipet e vogla. A do ia jepim një përqindje të fitores lojtarëve, që ishin të prekur në sedër?

Siç e thashë, dihet që në këto ndeshje të këtyre nivelit, ku ne e mendojmë se fitojmë lehtë, kemi gabuar në të shkuarën. Sot i kërkova çunave që jemi të detyruar ta fitojmë. Çdo gjë tjetër, është në dëmin tonë.


SULMUESI ÇËRRIKAS

Sadiku: Na provokuan, por u treguam profesionistë

Armando Sadiku gjeti golin me fanellën e Shqipërisë pas një mungese të gjatë dhe për 'RTSH Sport' u shpreh se ishte fitore për moral, duke pranuar se ishte ndeshje e vështirë. "Ishte e rëndësishme pas humbjes. U mblodhëm dhe kemi folur shumë. Duhet të mendojmë për ndeshjet e tjera. U dha maksimumi në një fushë të vështirë ndaj një kundërshtari të vështirë. Jam i lumtur që gjeta golin në Kombëtare. Morali? Është normale që kur hyjmë, hyjmë për fitore. Sot (dje) vetëm për moral ishte fitorja dhe vetëm për të erdhmë sot këtu dhe ia dolëm. Kishte shumë tipa që donin të na provokonin dhe protestonin shumë. U treguam profesionistë dhe vepruam me mençuri dhe ia dolëm", tha Sadiku.



Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL**
- Riza aktor.
 - Një fjalë si hijç.
 - Një mund të jetë diplomatik.
 - Premton të bëhet as.
 - Janë felinë... të zinj.
 - Ami i Maupassant.
 - Heroi i Emilio Salgarit.
 - Qe anarkist i famshëm rus
 - Një mungesë gjaku.
 - Susanna shkrimtare
 - Të parat në cilësi.
 - Mbyllin një shtëpi.
 - Mbeten në fund.
 - Zendër në kaos.
 - Ka bërë piktoreskë një i tillë
 - Inicialet e Camus.
 - Motra...e Kolë Idromenos
 - Një konfuzion total.
 - Rastet pa set.
 - Rastisin në krye.


- Fillojnë detyrën.
- Bektashi këngëtare.
- Andrea aktore.
- Sampras i tenisit.
- Shkroi Korbi (indic).
- Triplet e Trëndafilë me kredi.
- Kilmer aktor.
- Në krye të robotëve.
- Unë dhe ti.
- Një mund të jetë fetar.
- Stephane poet francez

- VERTIKAL**
- Fillojnë praktikikën.
 - Britma e Arkimedit.
 - Ekstreme në trap.
 - Në fund të fundit.
 - Janë fjetoret e ushtarëve
 - Parker regjisor.
 - Vivaldi kompozitor.
 - Një shkop për karambol.
 - Janë firmat rentiere.
 - Një i fundit mbi të gjithë
 - Kufizojnë tatimet
 - Janë nomadë.
 - Panik pa kufij.
 - Fryn detin
 - Sidney regjisor i Serpico.
 - Jep alarmin.
 - Fillojnë nazet.
 - Janë illogari.
 - Alan regjisor.
 - Roman regjisor.
 - Eshtë X ajo e sulmit.
 - Kapen të parat.
 - Një provë... inteligjence.
 - Një markë lap top.
 - Fillojnë matjet.
 - Rruga e Ferenc Molnar.
 - Qerre pa qe.
 - Fillojnë lirinë.
 - Fillojnë vallen.
 - Në mes të dhomës.

Fjalëkryqi (2)


- HORIZONTAL**
- Një doktor... i Fritz Lang
 - U paraprinë hoteleve.
 - Kush nuk ka... nuk ha
 - Eshtë djall
 - Një mund të ketë i rrallë.
 - Ishin perëndi të Samotrakias.
 - Institucione Botuese Autonome.
 - Eshtë infeksion në bark
 - Fundi i një samurai.
 - Një markë kafeje.
 - Mbyllin një hark.
 - Mund të jetë emërore.
 - Ishtë muzikanti që nuk përsiste.
 - Në krye të avokatëve.
 - Qerre pa qe.
 - Një pjesë e adolehentëve.
 - Një banor imagjinar i planetit të kuq.
 - Nuk shuhej dot nga Tantalit.

- Desnuda e Goya-s.
 - Ruhet ajo sportive.
 - Vetëvrasja e samurait.
 - Drita pa kufizj.
 - Eshtë yll i skuadrës.
 - I dashuri i Aidas.
 - Eshtë zhurmë
 - Ishtë lulja e harresës.
- VERTIKAL**
- James, armiku i Sherlock Holmes.
 - Eshtë edhe ajo saudite.
 - Imami aktore
 - I kanë gift turket.
 - Inicialet e Seagal aktor.
 - Eshtë dëshmore... çuditërisë.
 - Në fund të lutjes.
 - Eshtë sporti me stil të lirë.




- Mbeten në fund.
- Eshtë rasti i veçantë, karakteristik.
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Gjysmë ditari.
- Mario, që qe bomber argentinias.
- Mund të prishej nga një... kleçkë.
- Në hyrje të pistës.
- Një numër... femrash.
- Eshtë qyteti i Besës
- Qyteti që quhej edhe Sebaste.
- Njëllon për latinët.
- Mund të bëjnë stil të lirë.
- Damon aktor.
- Eshtë pije e jona.
- Në krye të noterëve.
- Film i Robert Altman.
- Skuadra merengue.
- Një pjesë e hasmërisë.
- Rralle është përgjysmë.
- Nisur pa kufij.
- Fillojnë mobilizimin.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

		6	8					9
4								1
2								
	5		7					8
1								9
7		4	6					
8				2	7			3
			4					6
3		1						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	1	8	5	7	2	4	6	3
7	3	4	9	1	6	2	5	8
2	5	6	8	3	4	7	9	1
8	7	2	4	9	3	6	1	5
1	9	3	7	6	5	8	4	2
6	4	5	1	2	8	9	3	7
5	8	7	6	4	1	3	2	9
3	6	1	2	8	9	5	7	4
4	2	9	3	5	7	1	8	6

Argëtim filozofik

- Nëse nuk tregon të vërteten për veten nuk mund të tregosh dot as për të tjerët.
- Kush jeton sipas të gjitha rregullave humb gjithë kënaqësitë.
- Cmenduri është të bësh gjithmonë të njëjtën gjë dhe të presësh rezultate të ndryshme.
- Disa njerëz janë shumë të varfër, gjithçka që ata kanë janë paratë.
- Që ti thuash të vërtetën dikuj që nuk të kupton, ndonjëherë është më keq sesa ta gënjesh.
- Forca e vullnetit është ajo që ju detyron të fitoni, kur logjika juaj thotë se ju keni humbur.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	2	9	13	15	11	7	2		1	11	2	7	K	U	L	T	M	A	P	L	A	B			
4	9	12	4	11		2		14	13	15	8	2	O	R	E	K	A	S	T	I	L	E	R		
1		12	4	2	12	4	11		6	1	8		R	U	L	A	K	T	O	R	I	A	L	E	
4	11	2			5	10	3	1	15		12	2	B	E	K	L	E	O	P	A	T	R	A		
7	4	12			5	10	3	4	6	1	7	2	12	I	E	K	I	T	R	E	T	E	S		
3			5	10	3	1	14	4	6	1				L	A	M	E	K	E	R	M	A	T		
4	12	2		5	1	7	2	12		11	4	3		T	E	R	M	A	T	A	R	I	C	E	
7	10	6	10		14	4	8		12	10	7	4		O	T	O	S	C	I	R	M	A			
12	11	1		9	4		12	6		8	15	8		B	R	E	D	H	I	A	I	R	K		
1	12		12	15	12	15		1	12	1		14		I	L	E	I	N	E	P	H	I	L		
7	2	14	4	12		7	K ¹⁰	O ⁹	S ¹³	H ³	3	4		A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	I
4	12	1	7		9	4	7	9	4	11	4	12		S	E	T	E	S	K	I	C	A	T	O	

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



Thënie të mençura

- Një grua e bukur është ferr i shpirtit, pastruese e xhepit, dhe parajsë e syve.
- Një njeri i kompletuar ka qetësi për të pranuar gjërat që nuk mund të ndryshojë, ka fuqi për të ndryshuar gjërat që mundet dhe mençurinë për të kuptuar diferencën.
- Mos kini frikë, kur ju eci ngadalë. Kini frikë vetëm kur ju qëndroni
- Kur ligji dhe morali përplasen me njëri-tjetrin, qytetari ka zgjedhjen të humbi perceptimin e moralit apo të humbi respektin e tij për ligjet.

